

Procesverbal- Tipi i kontratës - Shërbime

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

Objekti i procedurës: “Sistemimi dhe mirëmbajtja e rrugëve bujqësore”.

Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (FPP): 98341110-9, 77000000-0

Vlera e fondit limit: 83 333 333,33 (tetëdhjetë e tre milionë e treqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre) Lekë pa TVSH ose 894 134,47 (etëqind e nëntëdhjetë e katër mijë e njëqind e tridhjetë e katër euro e dyzet e shtatë cent) Euro. *(Vlera në Euro është konvertuar referuar Kursit zyrtar të këmbimit zyrtar (93.20), datë 06/082026).*

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Himarë, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 12;*

Argumentimi: Ky kriter është vendosur bazuar në nenin 82 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 5;*

Argumentimi: Ky kriter është vendosur bazuar në nenin 83 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar dhe nenin 30 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencë të vlefshme për zbatimin e kontratës, bazuar në formatin e miratuar me VKM nr. 42, datë 16.01.2008, „Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi“. Shqyrtimi i licencave do të bëhet mbi bazën e rregullave të parashikuara sa më sipër.

Licenca profesionale e Operatorit Ekonomik, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës, duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

Nr.	Licenca	Kategoria e kryerjes së punimeve
1	NP-I/A	Punime gjurmimi në tokë

- 2 NP-4/B Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroportuale
- 3 NP-5/A Punime nëntokësore, ura, vepra arti
- 4 NP-12/A Punime inxhinierike mjedisore
- 5 NS-6/B Sinjalistika rrugore jondriçuese

Shoqëritë e huaja duhet të bëjnë ekuivalentimin e licencave profesionale që disponojnë, të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë organeve kompetente, në përputhje me „Rregulloren për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” të miratuar me VKM nr. 42, datë 16.01.2008. Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është vendosur bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar ku parashikohet se “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës”, nenin 41, pika 4, gërma (a), të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, ku parashikohet se “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

- a) *licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore;”.*

Niveli i klasifikimit të kategorive të licensës është përcaktuar bazuar në vëllimin e punimeve të preventivit. Ky kriter është vendosur në përputhje me natyrën dhe kompleksitetin e punimeve që do të realizohen në kuadër të kësaj kontrate, si dhe në zbatim të legjislacionit në fuqi për prokurimin publik dhe licencimin e subjekteve që ushtrojnë veprimtari në fushën e ndërtimit dhe infrastrukturës rrugore.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 *Vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023, 2024 dhe 2025, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit që prokurohet. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1 (një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është bazuar në nenin 77, pika 3, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenin 43 pika 2/a dhe nenin 47 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “*Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata*”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar

nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomike dhe financiare për të përmbushur kontratën siç është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se vlera e fondit limit që prokurohet është në përputhje me përcaktimet në nenin 43 pika 2/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se *“Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: a) dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar”*. Në rastin konkret, nga ana e Njësisë së Prokurimit është konsideruar e arsyeshme që vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik, nxitjen e konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë si edhe sigurimin e një trajtimi të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë ofertuesit e mundshëm ekonomikë. Marrë shkas nga fakti që referuar përcaktimit të bërë në nenin 43 pika 2/a, AK nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së përlllogaritur të vlerës së lotit në kërkesën për kualifikim, por në respektim të parimeve ligjore dhe në përmbushjen e qëllimeve të ligjit të prokurimit si më sipër cituar ka tagrin të kërkojë një vlerë më të ulët se dyfishi i vlerës së përlllogaritur të kontratës për përmbushjen e vlerës së xhiros minimale vjetore. Kjo vlerë është kërkuar duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumen e saj, që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të certifikuara të bilanceve të viteve 2023, 2024 dhe 2025 të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, ku përcaktohet se: *“Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkohen një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit”*, si dhe në pikën 5 të nenit 61, të Ligjit nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: *“.....Tatimpaguesit që mbajnë kontabilitet sipas kërkesave të ligjit përkatës, paraqesin deklaratën vjetore së bashku me pasqyrat financiare, si dhe të dhëna të tjera të përcaktuara në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat për zbatimin e këtij ligji”*, si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” të ndryshuar dhe nenit 14 të Ligjit Nr. 10091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar” të ndryshuar.

Ky kriter, për paraqitjen e bilanceve, është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumen e saj, që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe

kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3. Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 39 % të vlerës së fondit të limit që prokurohet.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar në përputhje me nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe me nenin 41, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar ku parashikohet se “3. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.”. Përcaktimi i këtij kriteri të veçantë të kualifikimit është bërë me qëllim që operatorët ekonomikë pjesëmarrës të dëshmojnë se disponojnë përvojën e nevojshme profesionale dhe kapacitetet e duhura për realizimin me sukses të objektit të prokurimit.

Nëpërmjet këtij kriteri synohet të sigurohet që operatorët ekonomikë të cilët paraqesin ofertë të kenë një përvojë të mëparshme të konsoliduar në realizimin e shërbimeve të ngjashme me objektin e kësaj procedure prokurimi. Përvoja e mëparshme në realizimin e kontratave të ngjashme përbën një element të rëndësishëm në vlerësimin e aftësisë së operatorit ekonomik për të përmbushur detyrimet kontraktore, duke garantuar që ai ka njohuritë, kapacitetet organizative dhe profesionale, si dhe eksperiencën praktike të nevojshme për realizimin e shërbimeve objekt të kontratës.

Në këtë kuadër, është kërkuar që operatorët ekonomikë të dëshmojnë realizimin e shërbimeve të mëparshme të ngjashme në një vlerë jo më pak se 39% e vlerës së fondit limit. Ky nivel është përcaktuar duke mbajtur parasysh natyrën, kompleksitetin dhe specifikat e shërbimeve objekt të

prokurimit, si dhe nevojën për të siguruar një nivel të përshtatshëm eksperience nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, pa vendosur kërkesa të tepruara apo kufizuese për pjesëmarrjen në procedurë.

Përcaktimi i vlerës prej 39% të fondit limit është bërë në respektim të parimeve të proporcionalitetit, transparencës dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë, duke synuar një ekuilibër të drejtë ndërmjet nevojës së Autoritetit Kontraktor për të garantuar aftësinë dhe përvojën e operatorit ekonomik dhe nevojës për të siguruar konkurrencë sa më të gjerë dhe efektive në procedurën e prokurimit. Kjo vlerë konsiderohet e arsyeshme dhe proporcionale me objektin e kontratës, pasi nuk tejkalon kufirin e lejuar nga dispozitat ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe, njëkohësisht, garanton që operatori ekonomik i përzgjedhur të ketë një eksperiencë të mjaftueshme dhe të verifikueshme në realizimin e shërbimeve të ngjashme.

Në këtë mënyrë, kërkesa e përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor synon të garantojë që operatori ekonomik i përzgjedhur të jetë në gjendje të realizojë kontratën me sukses, brenda afateve të përcaktuara dhe në përputhje me standardet e kërkuara të cilësisë dhe specifikimet teknike. Përcaktimi i këtij kriteri nuk ka për qëllim kufizimin e konkurrencës, por vlerësimin objektiv të aftësisë së operatorëve ekonomikë për të përmbushur detyrimet që rrjedhin nga kontrata.

2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kësaj kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht 35 (tridhjetë e pesë) personash, për muajin Korrik 2026 vërtetuar me:

- a. Vërtetim të lëshuar nga administrata tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve.*
- b. Listëpagesat e punonjësve të konfirmuara nga autoritetet përkatëse sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi.*

Ky kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 12 të DT. Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar ku parashikohet se “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës” dhe nenin 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, ku parashikohet se „6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit;”.

Kriteri lidhet drejtpërdrejt me natyrën, volumet dhe organizimin e punimeve të parashikuara në specifikimet teknike.

Kërkesa për disponimin e një fuqie punëtore minimale prej 35 (tridhjetë e pesë) personash është përcaktuar në funksion të nevojave konkrete dhe objektive të zbatimit të kontratës me objekt “Sistemimi i rrugëve bujqësore”, duke marrë në konsideratë në mënyrë të integruar shtrirjen e rrjetit rrugor prej rreth 56 km, kohëzgjatjen 24-mujore të kontratës, natyrën e punimeve të parashikuara në preventiv, diversitetin e proceseve të punës dhe nevojën për organizimin e punimeve në segmente të ndryshme të rrjetit rrugor.

Në aspektin juridik, përcaktimi i këtij kriteri mbështetet në nevojën e Autoritetit Kontraktor për të verifikuar paraprakisht që operatorët ekonomikë pjesëmarrës zotërojnë kapacitetet e nevojshme profesionale, teknike dhe organizative për realizimin e kontratës. Kriteret e kualifikimit duhet të jenë të lidhura dhe proporcionale me objektin e kontratës dhe të shërbejnë për të garantuar që operatori ekonomik i përzgjedhur të ketë aftësinë reale për të përmbushur detyrimet kontraktore.

Në këtë kuadër, kërkesa për një numër minimal të fuqisë punëtore është vendosur si një kriter që lidhet drejtpërdrejt me objektin e prokurimit dhe me kapacitetin operacional që kërkohet për realizimin e tij. Kjo kërkesë synon të garantojë që operatori ekonomik i cili do të kontraktohet të ketë një kapacitet njerëzor të mjaftueshëm për të organizuar, menaxhuar dhe realizuar punimet e kontratës në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor.

Nga pikëpamja teknike, objekti i kontratës përfshin një rrjet rrugor bujqësor me gjatësi të konsiderueshme, prej rreth 56 km. Kjo shtrirje e konsiderueshme territoriale bën që punimet të mos përqendrohen në një kantier të vetëm dhe në një pikë të vetme pune, por të shtrihen në segmente të ndryshme të rrjetit rrugor. Për rrjedhojë, operatori ekonomik duhet të ketë mundësi reale për të organizuar burimet njerëzore në mënyrë të tillë që të përballojë nevojat e ndryshme të punimeve në territor dhe të shmangë vonesat që mund të shkaktohen nga mungesa e fuqisë punëtore.

Gjithashtu, kontrata ka një afat zbatimi prej 24 muajsh, çka kërkon që operatori ekonomik të ketë kapacitet të qëndrueshëm njerëzor gjatë një periudhe relativisht të gjatë kohore. Përgjatë kësaj periudhe, nuk parashikohet vetëm realizimi i një ndërhyrjeje të vetme, por një sërë procesesh pune që lidhen me sistemin dhe mirëmbajtjen e rrjetit rrugor bujqësor dhe të elementeve përbërëse të tij.

Në preventivin e kontratës janë përfshirë, ndër të tjera, punimet për pastrimin e kanaleve, pastrimin e tombinove ekzistuese, pastrimin e vegjetacionit, pastrimin e karrexhatës nga aluvionet dhe materialet e tjera, mbushjen dhe profilimin e rrugëve të shtruara me çakull dhe mirëmbajtjen rutinë të veprave të artit.

Këto punime kanë karakter dhe kërkesa të ndryshme operative dhe, në varësi të fazës së zbatimit të kontratës dhe gjendjes së segmenteve të ndryshme të rrjetit rrugor, mund të kërkojnë angazhimin e fuqisë punëtore në mënyrë të njëkohshme, të alternuar ose të shpërndarë në zona të ndryshme.

Për këtë arsye, kërkesa për minimalisht 35 punonjës është përcaktuar me qëllim që operatori ekonomik të ketë mundësi të organizojë disa grupe ose skuadra pune dhe të sigurojë një shpërndarje efektive të fuqisë punëtore sipas natyrës së punimeve dhe nevojave të zbatimit.

Në veçanti, punimet e pastrimit të kanaleve dhe tombinove kërkojnë ndërhyrje në elementë të ndryshëm të rrjetit të kullimit dhe të veprave ekzistuese, ndërsa pastrimi i vegjetacionit dhe i karrexhatës nga aluvionet dhe materialet e tjera kërkon ndërhyrje në vetë trupin dhe sipërfaqen e rrugës. Nga ana tjetër, mbushja dhe profilimi i rrugëve të shtruara me çakull përbën një proces pune që kërkon organizim të veçantë të fuqisë punëtore dhe koordinim me mjetet dhe pajisjet e nevojshme për realizimin e tij. Po kështu, mirëmbajtja rutinë e veprave të artit kërkon disponueshmërinë e personelit për ndërhyrje sipas nevojave që mund të evidentohen gjatë zbatimit të kontratës.

Në këtë kuptim, fuqia punëtore prej 35 personash përbën një kapacitet minimal operacional, i cili i mundëson operatorit ekonomik të organizojë punën në disa skuadra dhe të sigurojë fleksibilitetin e nevojshëm për përballimin e proceseve të ndryshme të punës. Ky numër nuk nënkupton që të gjithë 35 punonjësit do të jenë të angazhuar në mënyrë të pandërprerë dhe njëkohësisht në të njëjtin proces pune gjatë gjithë periudhës 24-mujore. Përkundrazi, ai përfaqëson kapacitetin minimal njerëzor që operatori ekonomik duhet të disponojë për të organizuar dhe menaxhuar punimet sipas fazave të zbatimit, planit të punës dhe nevojave konkrete të terrenit.

Përcaktimi i numrit prej 35 punonjësish është bërë duke marrë në konsideratë raportin ndërmjet gjatësisë së rrjetit prej 56 km dhe kompleksitetit të ndërhyrjeve të parashikuara. Nëse merret në konsideratë vetëm shtrirja territoriale e objektit, rezulton se për çdo kilometër të rrjetit rrugor korrespondon një kapacitet mesatar prej rreth 0.63 punonjësish për kilometër. Ky raport nuk përbën një normë të ngurtë personel/km, por shërben si një tregues i arsyeshëm i kapacitetit minimal të nevojshëm njerëzor për një kontratë me shtrirje të tillë dhe me disa kategori të ndryshme punimesh. Njëkohësisht, numri prej 35 punonjësish është përcaktuar duke pasur parasysh se rrjeti prej 56 km mund të kërkojë ndërhyrje në segmente të ndryshme dhe se punimet mund të zhvillohen në mënyrë të alternuar ose paralele. Disponimi i një numri të kufizuar punonjësish do ta bënte të vështirë organizimin e disa fronteve të punës dhe do të rriste riskun e vonësive në përbushjen e detyrimeve kontraktore.

Për më tepër, gjatë periudhës 24-mujore të kontratës, kushtet e motit, reshjet, prurjet dhe faktorë të tjerë natyrorë mund të ndikojnë në gjendjen e kanaleve, tombinove, karrexhatave dhe veprave të artit, duke krijuar nevojën për ndërhyrje në kohë në segmente të ndryshme. Për këtë arsye, operatori ekonomik duhet të ketë një kapacitet njerëzor të mjaftueshëm për të reaguar dhe për të realizuar ndërhyrjet e nevojshme pa cenuar vijueshmërinë e punimeve të tjera të planifikuara.

Nga ky këndvështrim, kriteri i fuqisë punëtore minimale prej 35 personash shërben edhe si një masë për menaxhimin dhe reduktimin e riskut të zbatimit të kontratës, duke synuar të garantojë që operatori ekonomik i përzgjedhur të ketë kapacitetin e nevojshëm për të përballuar volumin e punimeve, shtrirjen territoriale dhe kohëzgjatjen e kontratës.

Kërkesa është gjithashtu e lidhur me nevojën për të garantuar vazhdimësinë e punimeve. Duke qenë se kontrata shtrihet në 24 muaj, Autoriteti Kontraktor duhet të sigurohet se operatori ekonomik nuk disponon vetëm kapacitetin minimal për një ndërhyrje të momentit, por ka një strukturë njerëzore të mjaftueshme për të menaxhuar të gjithë ciklin e zbatimit të kontratës.

Sa i përket mënyrës së verifikimit të kriterit, kërkesa për paraqitjen e vërtetimit të administratës tatimore dhe të listëpagesave të konfirmuara nga autoritetet përkatëse synon të sigurojë një mënyrë objektive dhe të verifikueshme për të provuar disponimin e fuqisë punëtore të deklaruar nga operatori ekonomik. Këto dokumente i mundësojnë Autoritetit Kontraktor të verifikojë në mënyrë të besueshme ekzistencën dhe numrin e punonjësve të deklaruar.

Fakti që dokumentet provuese kërkohen nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të futesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose kur kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor, synon të sigurojë një proces verifikimi efikas dhe të shmangë ngarkesën e panevojshme dokumentare për të gjithë operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duke ruajtur njëkohësisht mundësinë e verifikimit të plotë të përbushjes së kriterit nga ofertuesi që rezulton i kualifikuar i pari.

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë 1 (një) inxhinier ndërtimi/1 (një) inxhinier hidroteknik, i përfshirë në licencën e shoqërisë.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr. 12. Përpara nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor i kërkon kandidatëve të kualifikuar në fazën e parë dorëzimin e këtyre dokumenteve: kontratë pune e vlefshme, diplomë, librezë pune dhe CV.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur bazuar në nenin 77, pika 4, e Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), nenin 41, pika 4/b, c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar) ku parashikohet se “4. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës, c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit”.

Kërkesa për disponimin e një inxhinieri ndërtimi ose inxhinieri hidroteknik, është përcaktuar në funksion të natyrës, objektit dhe kompleksitetit teknik të kontratës me objekt “Sistemimi i rrugëve bujqësore”, si dhe në konsideratë të punimeve të parashikuara në preventiv dhe të nevojës për mbikëqyrjen dhe drejtimin teknik të tyre gjatë gjithë periudhës së realizimit.

Nga pikëpamja juridike, kriteri synon të verifikojë që operatori ekonomik disponon kapacitetin e nevojshëm profesional dhe teknik për realizimin e kontratës. Kërkesa është e lidhur drejtpërdrejt me objektin e kontratës dhe synon garantimin e realizimit të punimeve në përputhje me projektin, preventivin, specifikimet teknike, standardet e zbatueshme dhe kërkesat e Autoritetit Kontraktor.

Kriteri është përcaktuar duke respektuar parimin e proporcionalitetit, pasi kërkohet vetëm një specialist teknik, me një nga dy profilet profesionale të lidhura drejtpërdrejt me natyrën e punimeve, konkretisht inxhinier ndërtimi ose inxhinier hidroteknik. Në këtë mënyrë, operatorëve ekonomikë u jepet mundësia të plotësojnë kriterin përmes njërit prej dy profileve profesionale, në varësi të organizimit dhe kapaciteteve të tyre, pa u kërkuar në mënyrë kumulative disponimi i të dy profileve. Kërkesa për një inxhinier ndërtimi ose hidroteknik justifikohet nga fakti se objekti i kontratës përfshin një kombinim punimesh që kanë karakteristika si të fushës së ndërtimit dhe të sistemimit të infrastrukturës rrugore, ashtu edhe të fushës së hidroteknikës dhe kullimit.

Në mënyrë konkrete, preventivi i kontratës përfshin pastrimin e kanaleve, pastrimin e tombinove ekzistuese, pastrimin e vegjetacionit, pastrimin e karrexhatës nga aluvionet dhe materialet e tjera, mbushjen dhe profilimin e rrugëve të shtruara me çakull dhe mirëmbajtjen rutinë të veprave të artit. Këto punime, ndonëse në thelb kanë karakter sistemimi dhe mirëmbajtjeje, kërkojnë drejtim dhe kontroll teknik për të garantuar që ndërhyrjet të kryhen në mënyrë të përshtatshme dhe të mos cenojnë funksionalitetin e rrugëve dhe veprave ekzistuese.

Në veçanti, punimet për mbushjen dhe profilimin e rrugëve të shtruara me çakull kërkojnë njohuri dhe kompetenca të fushës së ndërtimit, pasi duhet të sigurohet që profilimi i rrugës të realizohet në përputhje me kushtet ekzistuese të terrenit, parametrat teknikë të kërkuar dhe nevojat e funksionimit të rrugës.

Gjithashtu, pastrimi i karrexhatës nga aluvionet dhe materialet e tjera kërkon vlerësim dhe drejtim teknik për përcaktimin e mënyrës së ndërhyrjes dhe për garantimin që pastrimi dhe sistemimi të mos shkaktojë dëmtime në trupin e rrugës apo në elementet e saj përbërëse.

Nga ana tjetër, pastrimi i kanaleve dhe tombinove ekzistuese ka një rëndësi të veçantë nga pikëpamja hidroteknike, pasi këto elemente kanë funksionin e largimit dhe menaxhimit të ujërave dhe ndikojnë drejtpërdrejt në qëndrueshmërinë dhe funksionalitetin e rrugëve bujqësore. Një sistem kullimi i

dëmtuar, i bllokuar ose i pastruar në mënyrë jo të përshtatshme mund të ndikojë në grumbullimin e ujërave, në dëmtimin e trupit të rrugës dhe në reduktimin e jetëgjatësisë së ndërhyrjeve të kryera. Në këtë kuadër, përfshirja e një inxhinieri ndërtimi ose hidroteknik si drejtues teknik krijon garancinë që punimet do të organizohen dhe drejtohen nga një profesionist me formimin e nevojshëm për të vlerësuar kushtet teknike të terrenit, për të koordinuar proceset e punës dhe për të siguruar zbatimin e tyre në përputhje me kërkesat teknike.

Zgjedhja e alternativës “inxhinier ndërtimi / inxhinier hidroteknik” është e lidhur me karakterin e kombinuar të punimeve. Inxhinieri i ndërtimit disponon formimin profesional të përshtatshëm për proceset që lidhen me sistemimin dhe profilimin e rrugëve, ndërsa inxhinieri hidroteknik disponon formimin profesional të përshtatshëm për proceset që lidhen me kanalet, tombinot, kullimin dhe menaxhimin e ujërave. Për rrjedhojë, kërkesa për njërin prej këtyre profileve siguron që operatori ekonomik të ketë një drejtues teknik me formim profesional të lidhur me karakteristikat kryesore të objektit të kontratës.

Kërkesa që specialisti të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë lidhet me nevojën për të garantuar që operatori ekonomik disponon kapacitetin profesional dhe teknik të nevojshëm për të ushtruar aktivitetin përkatës dhe për të realizuar punimet objekt të kontratës në përputhje me kërkesat ligjore dhe profesionale në fuqi. Përfshirja e drejtuesit teknik në licencën e shoqërisë shërben si një element verifikues i kapacitetit profesional të operatorit ekonomik dhe i përgjegjësisë teknike për aktivitetin që do të ushtrohet.

Kërkesa për paraqitjen e kontratës së vlefshme të punës, diplomës, librezës së punës dhe CV-së synon të mundësojë verifikimin e plotë të kapacitetit profesional të specialistit të deklaruar. Diploma shërben për të verifikuar formimin arsimor dhe profilin profesional, kontrata e punës për të provuar lidhjen e vlefshme profesionale me operatorin ekonomik, librezja e punës për të verifikuar të dhënat e marrëdhënies së punës dhe eksperiencën profesionale, ndërsa CV-ja mundëson vlerësimin e përvojës dhe të angazhimeve profesionale të specialistit.

Kërkesa që dokumentet provuese të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, synon të sigurojë verifikimin e dokumentacionit të vetëdeklaruar nga operatori ekonomik që rezulton i kualifikuar i pari, duke shmangur ngarkesën administrative të panevojshme për të gjithë operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurë.

2.3.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të disponojë personelin kryesor (jo domosdoshmërisht të përfshirë në licencë), si më poshtë:

- 1 (një) inxhinier topograf;
- 1 (një) inxhinier mekanik.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr. 12.

Përpara nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor i kërkon kandidatëve të kualifikuar në fazën e parë dorëzimin e këtyre dokumenteve: kontratë pune e vlefshme, diplomë, librezë pune dhe CV.

Stafi i kërkuar në pikat 2.3.3 dhe 2.3.4 nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera apo të deklarohet në procedura të shpallura fituese.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur bazuar në nenin 77, pika 4, e Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), nenin 41, pika 4/b, c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar) ku parashikohet se “4. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale,

autoriteti/enti kontraktor kërkon: b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës, c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; ”.

Kërkesa për disponimin e personelit kryesor të përbërë nga 1 (një) inxhinier topograf dhe 1 (një) inxhinier mekanik është përcaktuar në funksion të natyrës, shtrirjes territoriale, kohëzgjatjes dhe kompleksitetit të kontratës me objekt “Sistemi i rrugëve bujqësore”, si dhe të proceseve të punës të parashikuara në preventiv.

Përcaktimi i këtij kriteri synon të garantojë që operatori ekonomik pjesëmarrës të disponojë kapacitetet profesionale dhe teknike të nevojshme për realizimin e kontratës dhe që, krahas drejtimit teknik të përgjithshëm të punimeve, të ketë në dispozicion edhe ekspertizën specifike të nevojshme për kontrollin topografik të punimeve dhe për menaxhimin dhe kontrollin teknik të mjeteve dhe makinerive të përdorura gjatë zbatimit të kontratës.

Kriteri është i lidhur drejtpërdrejt me objektin e kontratës dhe është përcaktuar duke respektuar parimin e proporcionalitetit, pasi kërkohet vetëm nga një specialist për secilin profil profesional, duke u kufizuar në ato profile që konsiderohen të nevojshme për realizimin e proceseve konkrete të punës. Kërkesa për disponimin e një inxhinieri topograf lidhet drejtpërdrejt me shtrirjen e konsiderueshme të objektit të kontratës, e cila përfshin një rrjet rrugor bujqësor me gjatësi prej rreth 56 km, si dhe me natyrën e punimeve që do të realizohen përgjatë këtij rrjeti.

Në preventivin e kontratës janë parashikuar punime për pastrimin e kanaleve, pastrimin e tombinove ekzistuese, pastrimin e vegjetacionit, pastrimin e karrexhatës nga aluvionet dhe materialet e tjera, mbushjen dhe profilimin e rrugëve të shtruara me çakull dhe mirëmbajtjen rutinë të veprave të artit. Një pjesë e rëndësishme e këtyre punimeve lidhet me ndërhyrje që ndikojnë në profilin gjatësor dhe tërthor të rrugës, në kuotat ekzistuese dhe në nivelimin e sipërfaqes së karrexhatës. Në këtë kuadër, disponimi i një inxhinieri topograf është i nevojshëm për kryerjen e kontrolleve dhe verifikimeve topografike që lidhen me gjendjen ekzistuese dhe me realizimin e punimeve të parashikuara.

Veçanërisht, punimet për mbushjen dhe profilimin e rrugëve të shtruara me çakull kërkojnë kontroll të vazhdueshëm të kuotave, pjerrësive dhe profileve të rrugës, me qëllim që ndërhyrjet të realizohen në përputhje me parametrat teknikë të përcaktuar dhe me kushtet e terrenit.

Inxhinieri topograf është i nevojshëm për të asistuar në:

- a) evidentimin dhe verifikimin e gjendjes faktike të segmenteve të rrugëve;
- b) kontrollin e kuotave dhe profileve të rrugës;
- c) verifikimin e profileve tërthore dhe gjatësore, sipas nevojave të zbatimit;
- d) kontrollin e punimeve të mbushjes dhe profilimit;
- e) verifikimin e niveleve dhe pjerrësive të sipërfaqes së rrugës;
- f) evidentimin e ndryshimeve të kushteve të terrenit gjatë zbatimit;
- g) mbështetjen teknike për matjet dhe verifikimet e nevojshme gjatë realizimit të punimeve.

Nevoja për këtë profil profesional bëhet veçanërisht e rëndësishme duke pasur parasysh se punimet nuk do të zhvillohen në një kantier të vetëm, por përgjatë një rrjeti prej rreth 56 km, duke kërkuar kontrolle dhe verifikime në segmente të ndryshme të territorit.

Në këtë kuadër, inxhinieri topograf shërben si një hallkë e rëndësishme në kontrollin teknik të zbatimit të punimeve, duke ndihmuar në garantimin që ndërhyrjet në rrugë të kryhen në mënyrë të kontrolluar dhe në përputhje me kërkesat teknike.

Disponimi i këtij specialisti është gjithashtu i lidhur me nevojën për të garantuar saktësinë e punimeve dhe për të reduktuar riskun e realizimit të profileve ose kuotave jo të përshtatshme, të cilat mund të ndikojnë në kullimin sipërfaqësor, qëndrueshmërinë dhe funksionalitetin e rrugës.

Në veçanti, kontrolli i pjerrësive dhe profileve të rrugëve ka rëndësi edhe në raport me pastrimin e kanaleve dhe tombinove, pasi funksionimi i rrjetit të kullimit dhe largimi i ujërave lidhen ngushtësisht me profilin dhe pjerrësinë e rrugës dhe me mënyrën se si ujërat sipërfaqësore drejtohen drejt elementeve të kullimit.

Për rrjedhojë, kërkesa për një inxhinier topograf është e lidhur drejtpërdrejt me natyrën e punimeve dhe me shtrirjen prej 56 km të objektit dhe synon të sigurojë që operatori ekonomik të ketë kapacitetin profesional për të kryer kontrollet dhe verifikimet topografike të nevojshme gjatë zbatimit të kontratës.

Kërkesa për disponimin e një inxhinieri mekanik lidhet me natyrën e punimeve objekt të kontratës, të cilat kërkojnë përdorimin dhe angazhimin e një numri të konsiderueshëm mjeteve dhe makinerish për realizimin e proceseve të punës.

Punimet e parashikuara në preventiv, veçanërisht pastrimi i kanaleve, pastrimi i tombinove, pastrimi i vegjetacionit, pastrimi i karrexhatës nga aluvionet dhe materialet e tjera dhe mbushja dhe profilimi i rrugëve të shtruara me çakull janë procese që, për nga natyra e tyre, kërkojnë përdorimin e mjeteve dhe makinerive të përshtatshme, si mjete transporti, makineri për gërmim dhe pastrim, mjete për ngarkim dhe transport të materialeve, si dhe makineri për nivelim dhe profilim.

Duke pasur parasysh shtrirjen prej rreth 56 km dhe kohëzgjatjen e kontratës prej 24 muajsh, operatori ekonomik duhet të ketë kapacitetin për të organizuar, menaxhuar dhe mirëmbajtur flotën e mjeteve dhe makinerive të nevojshme për realizimin e punimeve.

Në këtë kuadër, inxhinieri mekanik ka rol në aspektin e organizimit dhe kontrollit teknik të përdorimit të makinerive dhe pajisjeve, duke kontribuar në vlerësimin e përshtatshmërisë së makinerive me proceset konkrete të punës, organizimin dhe planifikimin e përdorimit të mjeteve dhe makinerive, kontrollin e gjendjes teknike dhe funksionale të pajisjeve, koordinimin e mirëmbajtjes periodike dhe parandaluese, identifikimin dhe trajtimin e problematikave teknike të mjeteve, reduktimin e kohës së ndërprerjes së punimeve për shkak të defekteve mekanike dhe garantimin e përdorimit sa më efikas të mjeteve dhe makinerive gjatë zbatimit të kontratës.

Kjo nevojë është e lidhur edhe me faktin se punimet do të realizohen përgjatë një rrjeti të gjerë prej 56 km dhe jo në një kantier të vetëm. Për rrjedhojë, planifikimi dhe organizimi i lëvizjes dhe përdorimit të makinerive në segmente të ndryshme të rrjetit rrugor merr një rëndësi të veçantë për garantimin e vijueshmërisë së punimeve.

Një problem teknik ose mekanik i një makinerie të rëndësishme mund të shkaktojë ndërprerjen e një procesi pune dhe të ndikojë në ecurinë e përgjithshme të kontratës. Për këtë arsye, disponimi i një inxhinieri mekanik i jep operatorit ekonomik mundësinë të ketë kapacitet profesional për administrimin dhe kontrollin teknik të mjeteve dhe makinerive të angazhuara në realizimin e punimeve.

Në këtë mënyrë, kërkesa për një inxhinier mekanik nuk është një kërkesë e shkëputur nga objekti i kontratës, por lidhet drejtpërdrejt me mënyrën konkrete të realizimit të punimeve dhe me nevojën për të garantuar funksionimin e vazhdueshëm dhe efikas të mjeteve dhe makinerive që do të përdoren gjatë zbatimit të kontratës.

Kërkesa për disponimin e një inxhinieri topograf dhe një inxhinieri mekanik është përcaktuar duke pasur parasysh se këta dy profile kanë funksione profesionale të ndryshme dhe plotësuese në realizimin e kontratës.

Inxhinieri topograf lidhet me kontrollin e matjeve, kuotave, profileve dhe parametrave gjeometrikë të punimeve, ndërsa inxhinieri mekanik lidhet me menaxhimin dhe kontrollin teknik të mjeteve dhe makinerive të nevojshme për realizimin e tyre.

Për rrjedhojë, këto dy profile nuk konsiderohen të zëvendësueshme me njëri-tjetrin, pasi secili mbulon një fushë specifike profesionale që lidhet me aspekte të ndryshme të zbatimit të kontratës.

Shtrirja e kontratës në rreth 56 km rrugë bujqësore dhe kohëzgjatja prej 24 muajsh janë elemente të rëndësishme në përcaktimin e këtij kriteri.

Në një kontratë të tillë, operatori ekonomik duhet të jetë në gjendje të menaxhojë në mënyrë të vazhdueshme dhe të organizuar procese pune në segmente të ndryshme të rrjetit rrugor. Kjo kërkon jo vetëm fuqi punëtore, por edhe kapacitete profesionale të specializuara për kontrollin e punimeve dhe administrimin teknik të burimeve mekanike.

Për këtë arsye, inxhinieri topograf dhe inxhinieri mekanik plotësojnë nevojat teknike të operatorit ekonomik në dy drejtime të rëndësishme të zbatimit të kontratës: saktësinë teknike të punimeve në terren dhe vazhdimësinë operacionale të proceseve të punës përmes menaxhimit të mjeteve dhe makinerive.

Kërkesa që personeli i përcaktuar në pikat 2.3.3 dhe 2.3.4 të mos jetë i angazhuar në kontrata të tjera ose të deklarohet në procedura të shpallura fituese lidhet me nevojën për të garantuar disponueshmërinë reale dhe efektive të personelit të deklaruar për zbatimin e kontratës objekt të prokurimit.

Duke qenë se kontrata ka një kohëzgjatje prej 24 muajsh dhe shtrihet në një gjatësi prej rreth 56 km, Autoriteti Kontraktor duhet të ketë garanci se personeli kryesor i deklaruar nga operatori ekonomik do të jetë realisht i disponueshëm për përmbushjen e detyrave të tij gjatë zbatimit të kontratës dhe nuk do të jetë i angazhuar në mënyrë të tillë në kontrata të tjera sa të pamundësojë përmbushjen e detyrimeve në këtë kontratë.

Kjo kërkesë synon të shmangë situatat e mbivendosjes së angazhimeve profesionale, ku i njëjti person deklarohet njëkohësisht si personel kryesor në disa kontrata ose procedura, pa pasur mundësi reale për të qenë i pranishëm dhe aktiv në të gjitha ato.

Përcaktimi i këtij kushti synon, për rrjedhojë, të garantojë që personeli i deklaruar nuk është vetëm formalisht i disponueshëm, por ka disponueshmëri reale dhe efektive për nevojat e kontratës.

Kërkesa për paraqitjen e kontratës së vlefshme të punës, diplomës, librezës së punës dhe CV-së synon të mundësojë verifikimin e plotë të personelit të deklaruar.

Diploma shërben për të provuar formimin profesional dhe profilin përkatës të specialistit; kontrata e punës provon marrëdhënien e vlefshme profesionale me operatorin ekonomik; librezja e punës shërben për verifikimin e të dhënave të punësimit dhe eksperiencës, ndërsa CV-ja mundëson vlerësimin e eksperiencës dhe përvojës profesionale të specialistit.

Përdorimi i Formularit të Vetëdeklarimit në fazën e parë të procedurës dhe kërkimi i dokumenteve provuese nga ofertuesi i kualifikuar synon të sigurojë një proces verifikimi efikas dhe proporcional, duke shmangur ngarkesën e panevojshme administrative për të gjithë operatorët ekonomikë pjesëmarrës, ndërkohë që ruhet mundësia e verifikimit të plotë të të dhënave të deklaruara nga operatori ekonomik i kualifikuar.

2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të disponojë personelin mbështetës, si më poshtë:

- 1 (një) inxhinier gjeolog/gjeoteknik;
- 1 (një) inxhinier mjedisi (i përfshirë në licencën e shoqërisë);
- 1 (një) inxhinier elektrik.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr. 12.

Përpara nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor i kërkon kandidatëve të kualifikuar në fazën e parë dorëzimin e këtyre dokumenteve: kontratë pune e vlefshme, diplomë, librezë pune dhe CV.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur bazuar në nenin 77, pika 4, e Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), nenin 41, pika 4/b, c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar) ku parashikohet se “4. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës, c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit;”.

Kërkesa për disponimin e personelit mbështetës të përbërë nga 1 (një) inxhinier gjeolog/gjeoteknik, 1 (një) inxhinier mjedisi dhe 1 (një) inxhinier elektrik është përcaktuar në funksion të natyrës, shtrirjes territoriale, kohëzgjatjes dhe specifikave teknike të kontratës me objekt “Sistemimi i rrugëve bujqësore”, si dhe të proceseve të ndryshme të punës të parashikuara në preventiv.

Objekti i kontratës shtrihet në një rrjet rrugor bujqësor me gjatësi rreth 56 km dhe ka një kohëzgjatje prej 24 muajsh. Për shkak të kësaj shtrirjeje dhe kohëzgjatjeje, punimet do të zhvillohen në segmente të ndryshme të rrjetit rrugor dhe në kushte të ndryshme terreni, duke kërkuar jo vetëm drejtim teknik të përgjithshëm, por edhe asistencë të specializuar në fusha të caktuara që lidhen me sigurinë teknike, qëndrueshmërinë e terrenit, mbrojtjen e mjedisit dhe sigurinë e funksionimit të pajisjeve apo instalimeve elektrike që mund të preken nga ndërhyrjet.

Në këtë kuadër, personeli mbështetës i kërkuar nuk synon të zëvendësojë drejtuesin teknik të punimeve apo personelin kryesor të përcaktuar në kriteret e tjera të kualifikimit, por të plotësojë kapacitetet profesionale të operatorit ekonomik me ekspertizë specifike, e cila mund të kërkohej në faza të ndryshme të zbatimit të kontratës.

Përcaktimi i këtij kriteri synon të garantojë që operatori ekonomik i përzgjedhur të ketë kapacitetin profesional për të trajtuar në mënyrë të specializuar problematika të veçanta që mund të shfaqen gjatë zbatimit të punimeve dhe të marrë masat e nevojshme për garantimin e cilësisë, sigurisë, qëndrueshmërisë dhe përputhshmërisë me kërkesat ligjore dhe teknike.

Kërkesa për disponimin e një inxhinieri gjeolog/gjeoteknik lidhet drejtpërdrejt me karakteristikat e terrenit ku shtrihet rrjeti i rrugëve bujqësore dhe me natyrën e punimeve që do të realizohen gjatë zbatimit të kontratës.

Punimet e parashikuara përfshijnë ndërhyrje në trupin dhe strukturën e rrugëve, veçanërisht nëpërmjet mbushjes dhe profilimit të rrugëve të shtruara me çakull, si dhe ndërhyrje që lidhen me pastrimin e kanaleve, tombinove dhe elementeve të tjera të rrjetit të kullimit.

Për shkak të shtrirjes prej rreth 56 km, rrjeti rrugor mund të përfshijë segmente me karakteristika të ndryshme gjeologjike, gjeoteknike dhe topografike. Kushtet e terrenit mund të ndryshojnë nga një segment në tjetrin dhe mund të ndikojnë në mënyrën e realizimit të ndërhyrjeve, në qëndrueshmërinë e trupit të rrugës dhe në sjelljen e materialeve të përdorura për mbushje dhe profilim.

Në këtë kuadër, inxhinieri gjeolog/gjeoteknik është i nevojshëm për të ofruar asistencë profesionale në:

- a) vlerësimin e karakteristikave të terrenit në segmentet ku do të kryhen ndërhyrjet;
- b) identifikimin e problematikave të mundshme të qëndrueshmërisë së terrenit;
- c) vlerësimin e kushteve të bazamentit dhe të trupit të rrugës;
- d) dhënien e rekomandimeve teknike për trajtimin e segmenteve problematike;
- e) vlerësimin e sjelljes së materialeve të përdorura për mbushje dhe profilim;
- f) identifikimin e zonave që mund të jenë të ekspozuara ndaj erozionit, rrëshqitjeve ose deformimeve;
- g) asistimin teknik në rastet kur kushtet reale të terrenit ndryshojnë nga ato të evidentuara në fazën e planifikimit.

Nevoja për këtë specialist lidhet edhe me faktin se ndërhyrjet në rrugët bujqësore nuk mund të trajtohen në mënyrë uniforme përgjatë gjithë gjatësisë prej 56 km. Kushtet e terrenit dhe gjendja e rrugëve mund të ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme, duke kërkuar vlerësime të specializuara në segmente të veçanta.

Veçanërisht, punimet e mbushjes dhe profilimit me çakull duhet të realizohen duke marrë në konsideratë gjendjen e bazamentit ekzistues dhe aftësinë mbajtëse të tij. Në rastet kur ekzistojnë problematika të stabilitetit ose të drenazhimit, ndërhyrja e pakontrolluar mund të mos japë rezultatet e pritshme dhe mund të sjellë deformime, dëmtime ose nevojë për ndërhyrje të përsëritura.

Për këtë arsye, disponimi i një inxhinieri gjeolog/gjeoteknik krijon një garanci shtesë për Autoritetin Kontraktor se operatori ekonomik ka akses në ekspertizën profesionale të nevojshme për trajtimin e problematikave gjeologjike dhe gjeoteknike që mund të evidentohen gjatë zbatimit të kontratës.

Kërkesa për disponimin e një inxhinieri mjedisi, i përfshirë në licencën e shoqërisë, lidhet me nevojën për garantimin e respektimit të kërkesave mjedisore gjatë realizimit të punimeve dhe me natyrën e proceseve të ndryshme që do të zhvillohen përgjatë rrjetit rrugor prej rreth 56 km.

Punimet e parashikuara në preventiv përfshijnë, ndër të tjera pastrimin e kanaleve, pastrimin e tombinove ekzistuese, pastrimin e vegjetacionit, pastrimin e karrexhatës nga aluvionet dhe materialet e tjera, mbushjen dhe profilimin e rrugëve me çakull dhe mirëmbajtjen rutinë të veprave të artit.

Këto procese mund të gjenerojnë materiale të ndryshme të hequra nga kanalet, tombinot, karrexhata dhe sipërfaqet e rrugëve, të cilat duhet të trajtohen, grumbullohen, transportohen dhe menaxhohen në përputhje me kërkesat mjedisore dhe legjislacionin në fuqi.

Pastrimi i kanaleve dhe tombinove mund të shoqërohet me largimin e materialeve të depozituara, ndërsa pastrimi i vegjetacionit mund të gjenerojë mbetje organike. Gjithashtu, pastrimi i karrexhatës nga aluvionet dhe materialet e tjera mund të kërkojë menaxhimin e materialeve të nxjerra nga zona e ndërhyrjes.

Në këtë kuadër, inxhinieri i mjedisit është i nevojshëm për të asistuar operatorin ekonomik në:

- a) identifikimin dhe menaxhimin e ndikimeve mjedisore të punimeve;
- b) menaxhimin e materialeve dhe mbetjeve të krijuara gjatë pastrimeve;
- c) përcaktimin e mënyrës së përshtatshme të grumbullimit dhe largimit të materialeve;
- d) marrjen e masave për parandalimin e ndotjes së tokës dhe ujërave;
- e) garantimin e respektimit të kërkesave mjedisore gjatë punimeve;
- f) kontrollin e ndikimit të punimeve mbi mjedisin përreth;
- g) marrjen e masave për minimizimin e pluhurit, ndotjes dhe shqetësimeve të tjera të mundshme gjatë punimeve.

Kjo nevojë bëhet veçanërisht e rëndësishme për shkak të shtrirjes së objektit në një gjatësi prej rreth 56 km, ku punimet mund të zhvillohen në zona rurale dhe pranë kanaleve, tombinove dhe elementeve të tjera të sistemit të kullimit.

Përfshirja e inxhinierit të mjedisit në licencën e shoqërisë lidhet me nevojën për të garantuar që operatori ekonomik disponon kapacitetet profesionale të kërkuara për aktivitetin përkatës dhe se ekspertiza mjedisore është pjesë e strukturës profesionale të shoqërisë.

Kërkesa për këtë profil profesional synon të reduktojë riskun e ndikimeve negative në mjedis gjatë zbatimit të kontratës dhe të sigurojë që proceset e punës të realizohen në përputhje me kërkesat mjedisore dhe me detyrimet ligjore në fuqi.

Kërkesa për disponimin e një inxhinieri elektrik lidhet me nevojën për të garantuar ekspertizën profesionale për trajtimin e problematikave elektrike që mund të shfaqen gjatë zbatimit të punimeve, veçanërisht në rastet kur punimet në terren zhvillohen pranë infrastrukturave ekzistuese elektrike ose kur përdoren pajisje dhe sisteme me komponentë elektrikë.

Duke pasur parasysh shtrirjen prej rreth 56 km, rrjeti rrugor bujqësor mund të përshkrojë zona ku mund të ekzistojnë linja elektrike, instalime, pajisje ose infrastruktura të tjera të lidhura me rrjetin energjetik. Punimet e pastrimit, sistemimit dhe profilimit mund të zhvillohen pranë këtyre infrastrukturave dhe, për këtë arsye, kërkohet që operatori ekonomik të ketë në dispozicion ekspertizën e nevojshme për të vlerësuar dhe menaxhuar rreziqet që lidhen me ndërhyrjet pranë instalimeve elektrike ekzistuese.

Inxhinieri elektrik mund të kontribuojë në:

- a) identifikimin dhe vlerësimin e rreziqeve elektrike gjatë punimeve;
- b) asistimin teknik në rastet kur punimet zhvillohen pranë linjave ose instalimeve elektrike;
- c) garantimin e respektimit të kërkesave të sigurisë në punë në lidhje me rreziqet elektrike;
- d) vlerësimin e kushteve të sigurisë për përdorimin e pajisjeve me komponentë elektrikë;
- e) koordinimin teknik me operatorët ose subjektet përgjegjëse për infrastrukturën elektrike, kur kjo është e nevojshme;
- f) dhënien e rekomandimeve teknike për shmangien e dëmtimeve të infrastrukturës ekzistuese.

Disponimi i këtij specialisti synon të reduktojë riskun e dëmtimit të mundshëm të infrastrukturës elektrike ekzistuese dhe të rrisë sigurinë gjatë realizimit të punimeve në terren.

Megjithatë, ky profil profesional do të angazhohet sipas nevojave konkrete të zbatimit të kontratës dhe nuk nënkupton se inxhinieri elektrik duhet të jetë i pranishëm në çdo moment të punimeve, por që operatori ekonomik duhet të ketë mundësi reale për ta vënë në dispozicion të kontratës sa herë që lind nevoja për ekspertizën e tij profesionale.

Tre profilet profesionale të kërkuara në këtë kriter mbulojnë fusha të ndryshme dhe plotësuese të zbatimit të kontratës.

Inxhinieri gjeolog/gjeoteknik lidhet me karakteristikat dhe qëndrueshmërinë e terrenit dhe të trupit të rrugës;

inxhinieri i mjedisit lidhet me menaxhimin e ndikimeve mjedisore dhe materialeve të krijuara gjatë punimeve;

inxhinieri elektrik lidhet me sigurinë dhe problematikën që mund të shfaqen gjatë punimeve pranë infrastrukturës elektrike ose gjatë përdorimit të pajisjeve me komponentë elektrikë.

Për rrjedhojë, këto profile nuk janë të mbivendosura dhe nuk mund të konsiderohen si zëvendësuese të njëri-tjetrit, pasi secili mbulon një fushë specifike të ekspertizës profesionale.

Kërkesa për nga një specialist për secilin profil është përcaktuar si një nivel minimal i nevojshëm për të garantuar aksesin e operatorit ekonomik në ekspertizën e specializuar, pa kërkuar një numër të tepruar personeli.

Shtrirja e kontratës në rreth 56 km rrugë bujqësore dhe kohëzgjatja prej 24 muajsh janë faktorë që rrisin kompleksitetin e menaxhimit të punimeve.

Për shkak të shtrirjes territoriale, kushtet e terrenit, problematikat mjedisore dhe infrastruktura ekzistuese mund të ndryshojnë nga një segment në tjetrin. Për këtë arsye, operatori ekonomik duhet të ketë në dispozicion personel me ekspertizë të ndryshme profesionale, i cili mund të angazhohet sipas nevojave konkrete të zbatimit.

Gjatë një periudhe 24-mujore mund të shfaqen problematika të ndryshme që nuk mund të parashikohen plotësisht në fazën e hartimit të dokumenteve të tenderit. Për këtë arsye, disponimi i personelit mbështetës siguron një kapacitet shtesë profesional për trajtimin e situatave teknike dhe mjedisore që mund të lindin gjatë zbatimit.

Kërkesa për paraqitjen e kontratës së vlefshme të punës, diplomës, librezës së punës dhe CV-së synon të verifikojë në mënyrë objektive dhe të dokumentuar kapacitetin profesional të personelit të deklaruar.

Diploma shërben për të provuar formimin profesional dhe profilin përkatës të specialistit; kontrata e punës provon marrëdhënien e vlefshme profesionale me operatorin ekonomik; librezja e punës shërben për verifikimin e të dhënave të punësimit dhe eksperiencës, ndërsa CV-ja mundëson vlerësimin e përvojës profesionale dhe të angazhimeve të mëparshme.

Përdorimi i Formularit të Vetëdeklarimit në fazën e parë të procedurës dhe kërkimi i dokumenteve provuese nga ofertuesi i kualifikuar synon të sigurojë një proces verifikimi proporcional dhe efikas, duke shmangur ngarkesën e panevojshme administrative për të gjithë operatorët ekonomikë pjesëmarrës dhe duke mundësuar verifikimin e plotë të kapacitetit të ofertuesit të kualifikuar.

2.3.6 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar minimalisht 6 (gjashtë) punonjës manovratorë. Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr. 12. Përpara nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor i kërkon kandidatëve të kualifikuar në fazën e parë dorëzimin e dokumenteve provuese: kontrata individuale të vlefshme të punës dhe dëshmi aftësie profesionale (të vlefshme), të lëshuara nga institucionet përkatëse.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se “4. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit”.

Kërkesa për disponimin e minimalisht 6 (gjashtë) punonjësve manovratorë, me kontrata individuale të vlefshme pune dhe dëshmi aftësie profesionale të vlefshme, është përcaktuar në funksion të natyrës së punimeve, shtrirjes territoriale të objektit, kohëzgjatjes së kontratës dhe nevojës për përdorimin e makinerive dhe mjeteve të ndryshme gjatë realizimit të kontratës me objekt “Sistemimi i rrugëve bujqësore”.

Kontrata ka një shtrirje të konsiderueshme territoriale, me një gjatësi të rrjetit rrugor prej rreth 56 km, dhe një kohëzgjatje prej 24 muajsh. Për realizimin e punimeve të parashikuara në preventiv kërkohet

përdorimi i makinerive të ndryshme, të cilat duhet të operohen nga persona të kualifikuar dhe me aftësinë profesionale përkatëse.

Në mënyrë konkrete, preventivi i kontratës përfshin pastrimin e kanaleve, pastrimin e tombinove ekzistuese, pastrimin e vegjetacionit, pastrimin e karrexhatës nga aluvionet dhe materialet e tjera, mbushjen dhe profilimin e rrugëve të shtruara me çakull dhe mirëmbajtjen rutinë të veprave të artit.

Realizimi i këtyre proceseve kërkon angazhimin e makinerive dhe mjeteve të përshtatshme, të cilat, për shkak të natyrës së tyre, duhet të operohen nga manovratorë të pajisur me aftësitë profesionale përkatëse.

Punimet objekt kontrate nuk janë punime që mund të realizohen vetëm me fuqi punëtore të pakualifikuar, pasi një pjesë e konsiderueshme e proceseve të punës kërkon përdorimin e mjeteve dhe makinerive të rënda ose të specializuara.

Në veçanti, për realizimin e punimeve të pastrimit të kanaleve, tombinove, vegjetacionit dhe karrexhatës, si dhe për mbushjen dhe profilimin e rrugëve të shtruara me çakull, operatori ekonomik duhet të ketë në dispozicion makineri të përshtatshme dhe personel të aftë për operimin e tyre.

Manovratori është personeli që realizon drejtpërdrejt operimin e makinerive sipas llojit të pajisjes dhe funksionit të saj, duke ndikuar drejtpërdrejt në sigurinë, cilësinë dhe ecurinë e punimeve.

Për këtë arsye, disponimi i manovratorëve me dëshmi aftësie profesionale të vlefshme është i nevojshëm për të garantuar që makineritë të përdoren nga persona me kompetencat dhe aftësitë e kërkuara për funksionimin e tyre.

Kërkesa për dëshmi aftësie profesionale të vlefshme synon të sigurojë që personat e deklaruar si manovratorë kanë kualifikimin e nevojshëm për të operuar makineritë për të cilat kërkohet aftësi profesionale, duke reduktuar riskun e aksidenteve, dëmtimeve të makinerive dhe realizimit jo të përshtatshëm të punimeve.

Përcaktimi i numrit minimal prej 6 (gjashtë) manovratorësh është bërë duke marrë në konsideratë jo vetëm numrin e proceseve të punës, por edhe nevojën për të realizuar ndërhyrje në segmente të ndryshme të rrjetit rrugor prej rreth 56 km.

Objekti i kontratës nuk konsiston në një ndërhyrje të vetme dhe të përqendruar në një kantier të vetëm, por në sistemimin dhe mirëmbajtjen e një rrjeti rrugor të shpërndarë në territor.

Për rrjedhojë, operatori ekonomik duhet të ketë kapacitetin për të organizuar njëkohësisht disa procese pune dhe për të angazhuar makineri të ndryshme në segmente të ndryshme të objektit.

Kërkesa për 6 manovratorë synon të garantojë që operatori ekonomik të mos mbështetet në një numër tepër të kufizuar operatorësh, të cilët do të detyroheshin të lëviznin vazhdimisht nga një segment në tjetrin, duke shkaktuar ndërprerje dhe vonesa në realizimin e punimeve.

Në kushtet e një rrjeti prej 56 km, nevoja për manovratorë të mjaftueshëm është e rëndësishme për të garantuar organizimin e disa fronteve të punës, vijueshmërinë e proceseve të punës, përdorimin e njëkohshëm të makinerive të ndryshme, reduktimin e kohës së pritjes dhe ndërprerjeve, mundësinë e zhvendosjes së ekipeve në segmente të ndryshme të rrjetit, reagimin në kohë ndaj problematikave që mund të evidentohen gjatë zbatimit dhe realizimin e punimeve brenda afatit 24-mujor të kontratës.

Numri prej 6 manovratorësh përfaqëson një nivel minimal të kapacitetit njerëzor të nevojshëm për të operuar makineritë dhe për të garantuar vijueshmërinë e proceseve të punës, pa nënkuptuar që të gjithë manovratorët duhet të jenë domosdoshmërisht të angazhuar në të njëjtin moment në një segment të vetëm të rrugës.

Kërkesa për 6 manovratorë lidhet drejtpërdrejt me proceset e punës të parashikuara në preventiv.

Pastrimi i kanaleve kërkon përdorimin e makinerive të përshtatshme për pastrimin dhe largimin e materialeve të depozituara. Në varësi të kushteve të terrenit dhe aksesit në kanale, këto punime mund të kërkojnë angazhimin e makinerive të ndryshme dhe rrjedhimisht të manovratorëve përkatës.

Pastrimi i tombinove ekzistuese mund të kërkojë përdorimin e mjeteve dhe makinerive të përshtatura me kushtet e ndërhyrjes, veçanërisht në rastet kur materialet e depozituara duhet të largohen mekanikisht.

Pastrimi i vegjetacionit kërkon përdorimin e mjeteve dhe pajisjeve të përshtatshme për prerje, pastrim dhe largim të materialeve, duke kërkuar personel të aftë për operimin e tyre.

Pastrimi i karrexhatës nga aluvionet dhe materialet e tjera kërkon angazhimin e mjeteve për grumbullimin, ngarkimin dhe transportin e materialeve, si dhe makineri për pastrimin dhe sistemin e sipërfaqes së rrugës.

Mbushja dhe profilimi i rrugëve të shtruara me çakull përbën një nga proceset kryesore të kontratës dhe kërkon përdorimin e makinerive të përshtatshme për transportin, shpërndarjen, nivelimin dhe profilimin e materialit.

Mirëmbajtja rutinë e veprave të artit mund të kërkojë përdorimin e mjeteve dhe makinerive të ndryshme në varësi të natyrës së ndërhyrjes dhe kushteve të objektit.

Për rrjedhojë, duke marrë në konsideratë kombinimin e këtyre proceseve, kërkohet që operatori ekonomik të disponojë një numër minimal manovratorësh të aftë për të operuar makineritë e nevojshme për realizimin e punimeve.

Shtrirja prej rreth 56 km është një nga faktorët kryesorë që justifikon përcaktimin e numrit minimal prej 6 manovratorësh.

Në një kontratë të kësaj natyre, punimet mund të zhvillohen në segmente të ndryshme dhe në kohë të ndryshme, në varësi të prioriteteve të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor, kushteve të motit, aksesueshmërisë së segmenteve dhe nevojave të ndërhyrjes.

Për këtë arsye, operatori ekonomik duhet të ketë kapacitet të mjaftueshëm njerëzor për të menaxhuar njëkohësisht më shumë se një proces pune ose më shumë se një segment të rrjetit rrugor.

Disponimi i vetëm i një numri shumë të kufizuar manovratorësh do të krijonte riskun që makineritë të mos mund të përdoren në mënyrë të njëkohshme dhe që proceset e punës të varen nga përfundimi i një pune përpara fillimit të një pune tjetër.

Kjo do të ndikonte në produktivitetin dhe në aftësinë e operatorit ekonomik për të përmbushur detyrimet kontraktore brenda afatit 24-mujor.

Për këtë arsye, kërkesa për 6 manovratorë synon të sigurojë një kapacitet minimal operacional, i cili i jep operatorit ekonomik mundësinë të organizojë punimet në mënyrë të përshtatshme përgjatë gjithë shtrirjes së objektit.

Kohëzgjatja prej 24 muajsh e kontratës kërkon që operatori ekonomik të ketë kapacitet të qëndrueshëm njerëzor dhe teknik gjatë gjithë periudhës së zbatimit.

Duke qenë se punimet do të kryhen në një periudhë relativisht të gjatë, operatori ekonomik duhet të jetë në gjendje të përballojë nevojat e ndryshme operative që mund të shfaqen gjatë zbatimit, duke ruajtur vijueshmërinë e punimeve edhe në rast të nevojës për mirëmbajtje, zëvendësim ose riorganizim të makinerive.

Disponimi i 6 manovratorëve krijon një bazë minimale njerëzore që i mundëson operatorit ekonomik të planifikojë dhe organizojë punimet gjatë gjithë periudhës së kontratës dhe të shmangë varësinë nga një numër tepër i kufizuar personash.

Kërkesa që manovratorët të jenë të pajisur me kontrata individuale të vlefshme pune synon të garantojë disponueshmërinë reale dhe efektive të personelit të deklaruar.

Kjo kërkesë siguron që personat e deklaruar nga operatori ekonomik nuk janë thjesht persona të identifikuar për qëllime formale të procedurës së prokurimit, por janë realisht pjesë e burimeve njerëzore të operatorit ekonomik dhe mund të angazhohen në zbatimin e kontratës.

Duke pasur parasysh kohëzgjatjen 24-mujore të kontratës dhe nevojën për vijueshmëri të punimeve, disponimi real i manovratorëve është i rëndësishëm për garantimin e kapacitetit operacional të operatorit ekonomik.

Kërkesa për paraqitjen e dëshmive të aftësisë profesionale të vlefshme, të lëshuara nga institucionet përkatëse, lidhet drejtpërdrejt me natyrën e detyrave që do të kryejnë manovratorët.

Operimi i makinerive të ndryshme kërkon aftësi dhe kompetenca të veçanta profesionale dhe, në varësi të llojit të makinerisë, mund të kërkojë dokumentacion të posaçëm që provon aftësinë e personit përkatës.

Për këtë arsye, Autoriteti Kontraktor kërkon që personat e deklaruar si manovratorë të jenë të pajisur me dokumentacion të vlefshëm që provon aftësinë e tyre profesionale, duke garantuar që makineritë do të operohen nga persona të kualifikuar.

Kjo kërkesë synon të garantojë sigurinë e punonjësve dhe të personave të tretë, përdorimin e sigurt të makinerive, reduktimin e riskut të aksidenteve, reduktimin e dëmtimeve të makinerive, rritjen e cilësisë së punimeve dhe garantimin e operimit profesional të mjeteve dhe pajisjeve.

Kriteri konsiderohet i përmbushur në fazën e parë me paraqitjen e Formularit të Vetëdeklarimit, ndërsa dokumentet provuese kërkohej nga ofertuesi i kualifikuar. Kjo mënyrë verifikimi synon të sigurojë një proces proporcional dhe efikas të vlerësimit, duke mos ngarkuar të gjithë operatorët ekonomikë pjesëmarrës me paraqitjen e menjëhershme të dokumentacionit provues.

Në të njëjtën kohë, kërkimi i dokumenteve nga ofertuesi i kualifikuar mundëson verifikimin e plotë të deklarimit të bërë dhe garanton që operatori ekonomik që do të shpallet fitues disponon realisht personelin e deklaruar.

2.3.7 Operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë punonjës të specializuar/kualifikuar, si më poshtë:

- *1 (një) punonjës të pajisur me certifikatë „Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave “e cila të jetë lëshuar nga shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë;*
- *1 (një) punonjës që disponon certifikatën si „Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë “në përputhje me klauzolat e Ligjit nr. 10327, datë 18.02.2010, „Për sigurinë dhe shëndetin në punë, dhe VKM-së nr. 312, datë 05.05.2010, „Për miratimin e rregullores „Për sigurinë në kantier”.*

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr. 12.

Përpara nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon kandidatëve të kualifikuar në fazën e parë dorëzimin e dokumenteve provuese: kontratë pune të vlefshme, diplomë dhe certifikatat e cituara më sipër.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur bazuar në nenin 77, pika 4, e Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), nenin 41, pika 5/b, c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar) ku parashikohet se “Për të provuar

përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës, c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit;”.

Kërkesa për disponimin e personelit të specializuar dhe të kualifikuar në fushën e ndihmës së parë, ndërhyrjes ndaj emergjencave dhe sigurisë dhe shëndetit në punë është përcaktuar në funksion të natyrës së punimeve, mënyrës së organizimit të aktivitetit në terren, shtrirjes së konsiderueshme të objektit dhe kohëzgjatjes së kontratës.

Kontrata me objekt “Sistemi i rrugëve bujqësore” shtrihet në një rrjet rrugor me gjatësi prej rreth 56 km dhe ka një kohëzgjatje prej 24 muajsh. Punimet do të zhvillohen në segmente të ndryshme të rrjetit rrugor dhe do të përfshijnë procese të ndryshme pune, të cilat kërkojnë përdorimin e mjeteve dhe makinerive, transportin e materialeve, lëvizjen e punonjësve dhe ndërhyrjen në zona të ndryshme të territorit.

Në preventivin e kontratës janë parashikuar, ndër të tjera pastrimi i kanaleve, pastrimi i tombinove ekzistuese, pastrimi i vegjetacionit, pastrimi i karrexhatës nga aluvionet dhe materialet e tjera, mbushja dhe profilimi i rrugëve të shtruara me çakull dhe mirëmbajtja rutinë e veprave të artit.

Realizimi i këtyre proceseve të punës shoqërohet me përdorimin e makinerive dhe mjeteve të ndryshme, lëvizjen e mjeteve të transportit dhe punën e personelit në terren. Për këtë arsye, ekziston nevoja për marrjen e masave të përshtatshme për parandalimin e aksidenteve dhe për menaxhimin e situatave të papritura që mund të lindin gjatë realizimit të punimeve.

Në këtë kuadër, kërkesa për disponimin e dy profileve të specializuara, konkretisht një ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave dhe një përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë, synon të krijojë një strukturë minimale profesionale për trajtimin e dy aspekteve të ndryshme, por të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën: reagimin ndaj emergjencave dhe parandalimin dhe menaxhimin e rreziqeve në punë.

Kërkesa për disponimin e një punonjësi të pajisur me certifikatë “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave” lidhet me nevojën për të garantuar që operatori ekonomik të ketë në dispozicion një person të trajnuar dhe të kualifikuar për të dhënë ndihmën e parë dhe për të ndërmarrë veprimet fillestare në rast të situatave emergjente që mund të ndodhin gjatë punimeve.

Punimet objekt kontrate do të zhvillohen në një territor me shtrirje prej rreth 56 km, në segmente të ndryshme të rrjetit rrugor dhe në zona ku aksesit dhe distanca nga qendrat e shërbimeve të emergjencës mund të ndryshojnë.

Në këto kushte, disponimi i një personi të trajnuar për ndihmën e parë është i rëndësishëm për reagimin e menjëhershëm në rast të dëmtimeve të punonjësve gjatë proceseve të punës, aksidenteve të mundshme gjatë përdorimit të makinerive, dëmtimeve që mund të ndodhin gjatë ngarkimit, shkarkimit dhe transportit të materialeve, rrëzimeve ose dëmtimeve gjatë punimeve në terren dhe situatave të tjera të papritura që mund të kërkojnë ndërhyrje të menjëhershme.

Në veçanti, përdorimi i makinerive të rënda dhe mjeteve të ndryshme për pastrimin e kanaleve, tombinove, vegjetacionit dhe karrexhatës, si dhe për mbushjen dhe profilimin e rrugëve me çakull, krijon nevojën për një organizim të përshtatshëm të masave të sigurisë dhe për disponimin e personelit të trajnuar për reagimin fillestar ndaj emergjencave.

Eksperti për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave nuk zëvendëson shërbimet profesionale të urgjencës mjekësore, por ka rol në reagimin e parë, dhënien e ndihmës fillestare dhe marrjen e masave të nevojshme deri në mbërritjen e strukturave të specializuara të emergjencës.

Kjo është veçanërisht e rëndësishme në kushtet kur punimet shtrihen në një gjatësi prej 56 km dhe mund të zhvillohen në zona të ndryshme dhe potencialisht larg qendrave urbane.

Kërkesa që certifikata të jetë lëshuar nga shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë synon të sigurojë që trajnimi dhe kualifikimi i personit të deklaruar të jetë i besueshëm, i verifikueshëm dhe i njohur sipas kërkesave përkatëse.

Kërkesa për disponimin e një punonjësi që disponon certifikatën si “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë” lidhet me nevojën për të garantuar që gjatë zbatimit të kontratës të ketë një person me përgjegjësi dhe kompetencë profesionale për çështjet e sigurisë dhe shëndetit në punë.

Për nga natyra, punimet objekt kontrate zhvillohen në kushte pune në terren dhe përfshijnë përdorimin e makinerive, mjeteve të transportit dhe pajisjeve të ndryshme.

Rreziqet potenciale lidhen, ndër të tjera, me përdorimin e makinerive të rënda, lëvizjen e mjeteve në zonat e punimeve, punën pranë kanaleve dhe tombinove, punën në terrene të pabarabarta, ekspozimin ndaj pluhurit dhe materialeve të ndryshme, ngarkimin, shkarkimin dhe transportin e materialeve, ndërveprimin ndërmjet punonjësve dhe makinerive dhe punimet në segmente të ndryshme dhe potencialisht të vështira për akses.

Në këtë kuadër, përgjegjësi për sigurinë dhe shëndetin në punë ka rol në identifikimin dhe vlerësimin e rreziqeve, në marrjen e masave parandaluese dhe në monitorimin e respektimit të rregullave të sigurisë gjatë zbatimit të punimeve.

Kërkesa synon të garantojë që operatori ekonomik të ketë një person të dedikuar dhe të kualifikuar për të ndjekur çështjet e sigurisë dhe shëndetit në punë dhe për të kontribuar në krijimin e një mjedisi pune sa më të sigurt për punonjësit.

Në kushtet e një kontrate që shtrihet në rreth 56 km dhe ka një kohëzgjatje prej 24 muajsh, nevoja për një person përgjegjës për sigurinë dhe shëndetin në punë është e rëndësishme për të siguruar një qasje të vazhdueshme dhe të organizuar ndaj menaxhimit të rreziqeve.

Shtrirja territoriale prej rreth 56 km dhe kohëzgjatja prej 24 muajsh përbëjnë faktorë të rëndësishëm në përcaktimin e këtij kriteri.

Punimet nuk do të realizohen në një kantier të vetëm dhe të përqendruar, por në segmente të ndryshme të rrjetit rrugor. Për rrjedhojë, kushtet e punës dhe rreziqet potenciale mund të ndryshojnë nga një segment në tjetrin.

Gjatë kësaj periudhe, operatori ekonomik duhet të ketë kapacitetin për të menaxhuar në mënyrë të vazhdueshme çështjet e sigurisë dhe për të reaguar në mënyrë të përshtatshme ndaj situatave emergjente.

Për këtë arsye, kërkesa për dy persona me profile specifike profesionale siguron një nivel minimal të kapacitetit organizativ dhe profesional për parandalimin e aksidenteve, identifikimin e rreziqeve, reagimin ndaj situatave emergjente, dhënien e ndihmës së pare, garantimin e respektimit të masave të sigurisë dhe mbrojtjen e shëndetit të punonjësve.

Kjo kërkesë nuk nënkupton që të dy specialistët duhet të jenë domosdoshmërisht të pranishëm në çdo moment në çdo segment të rrjetit prej 56 km, por që operatori ekonomik duhet t'i ketë realisht në dispozicion dhe të organizojë angazhimin e tyre në funksion të nevojave të kontratës.

Kërkesa për dy persona të ndryshëm është e justifikuar nga fakti se rolet e tyre janë të ndryshme.

Eksperti për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave ka fokus kryesor reagimin fillestar në rast të një emergjence dhe dhënien e ndihmës së parë.

Ndërsa përgjegjësi për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë ka fokus kryesor parandalimin e rreziqeve, identifikimin dhe vlerësimin e tyre dhe monitorimin e zbatimit të masave të sigurisë dhe shëndetit në punë.

Për rrjedhojë, këto dy funksione janë të ndryshme dhe plotësuese. I pari lidhet kryesisht me reagimin ndaj pasojave të një situatë emergjente, ndërsa i dyti me parandalimin dhe menaxhimin e rreziqeve që mund të shkaktojnë një situatë të tillë.

Përcaktimi i vetëm nga një person për secilin funksion konsiderohet një kërkesë minimale dhe proporcionale me natyrën dhe shtrirjen e kontratës.

Një element i rëndësishëm në përcaktimin e këtij kriteri është përdorimi i makinerive dhe mjeteve të ndryshme për realizimin e punimeve. Për realizimin e punimeve të pastrimit të kanaleve, tombinove, vegjetacionit dhe karrexhatës, si dhe për mbushjen dhe profilimin e rrugëve me çakull, do të përdoren mjete dhe makineri që kërkojnë respektimin e rregullave të sigurisë dhe organizim të kujdesshëm të proceseve të punës. Në këto kushte, përgjegjësi për sigurinë dhe shëndetin në punë ka rol në kontrollin e masave të sigurisë që lidhen me përdorimin e makinerive dhe me ndërveprimin e tyre me punonjësit. Në rast të një incidenti, eksperti i ndihmës së parë dhe ndërhyrjes ndaj emergjencave mund të ndërhyjë menjëherë për dhënien e ndihmës së parë dhe për zbatimin e procedurave fillestare të emergjencës.

Kjo strukturë e dyfishtë ndihmon në krijimin e një sistemi të integruar të menaxhimit të sigurisë, i cili përfshin si parandalimin, ashtu edhe reagimin.

Kërkesa për paraqitjen e një kontrate pune të vlefshme synon të garantojë që personat e deklaruar janë realisht të disponueshëm për operatorin ekonomik dhe mund të angazhohen në zbatimin e kontratës. Kjo është e rëndësishme për të shmangur situatat kur një operator ekonomik deklaron persona vetëm për qëllime formale, pa pasur një marrëdhënie reale dhe të vlefshme me ta.

Duke pasur parasysh kohëzgjatjen 24-mujore të kontratës, disponimi real i personelit të specializuar është i nevojshëm për të garantuar vijueshmërinë e menaxhimit të sigurisë dhe të reagimit ndaj emergjencave gjatë gjithë periudhës së zbatimit.

Kërkesa për paraqitjen e diplomës dhe certifikatave përkatëse synon të mundësojë verifikimin objektiv të formimit profesional dhe kualifikimit të personelit të deklaruar. Certifikata e ekspertit për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave shërben për të provuar që personi ka kryer trajnimin dhe zotëron aftësitë përkatëse. Certifikata si përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë shërben për të provuar që personi disponon kualifikimin profesional të nevojshëm për të ushtruar funksionet që lidhen me sigurinë dhe shëndetin në punë. Diploma shërben për verifikimin e formimit arsimor dhe profesional të personit të deklaruar, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe legjislacionin përkatës.

Kriteri konsiderohet i përmbushur në fazën e parë të procedurës me plotësimin e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ndërsa dokumentet provuese kërkohen nga ofertuesi i kualifikuar. Kjo mënyrë verifikimi synon të sigurojë një proces proporcional dhe efikas, duke shmangur ngarkesën administrative të panevojshme për të gjithë operatorët ekonomikë pjesëmarrës.

Në të njëjtën kohë, kërkimi i dokumenteve provuese nga ofertuesi i kualifikuar mundëson verifikimin e plotë të deklarimeve të bëra dhe siguron që personeli i deklaruar disponon realisht kualifikimet dhe dokumentacionin e kërkuar.

2.3.8 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Nr.	Lloji i makinerive	Pronësia	Sasia
1	Mjet transporti vetëshkarkues mbi 8 ton	Në pronësi ose me qira	3 copë
2	Grejder	Në pronësi ose me qira	1 copë
3	Rrul vibrues	Në pronësi ose me qira	1 copë
4	Betoniere	Në pronësi ose me qira	1 copë
5	Autobot uji	Në pronësi ose me qira	1 copë
6	Motomjet ose agregatë për prerjen e bimësisë së ulët	Në pronësi ose me qira	6 copë
7	Kamionçinë deri në 3.5 ton	Në pronësi ose me qira	3 copë
8	Minieskavator	Në pronësi ose me qira	2 copë
9	Minifadromë (Bobcat ose ekuivalent)	Në pronësi ose me qira	2 copë
10	Ekskavator me goma	Në pronësi ose me qira	2 copë
11	Traktor i pajisur me agregat për prerjen e bimësisë	Në pronësi ose me qira	1 copë
12	Fabrikë për prodhimin dhe furnizimin me inerte dhe beton, e pajisur me QKL dhe leje mjedisore	Në pronësi/qira/kontratë furnizimi	1 copë

Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr. 12. Përpara nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon kandidatëve të kualifikuar në fazën e parë dorëzimin e dokumenteve provuese, si më poshtë:

- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vërteton pronësinë e mjetit: certifikata e pronësisë, leja e qarkullimit, certifikata e kontrollit teknik, siguracioni, leja e transportit e lëshuar nga njësia vendore dhe fotot përkatëse. Ndërsa, për mjetet e marra me qira, krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë, e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën deri në përfundimin e plotë të punimeve.
- Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes ose fatura e zhdoganimit ose fatura tatimore përkatëse, si dhe fotot. Ndërsa, për mjetet e marra me qira, krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë, e cila duhet të përfshijë objektin përkatës dhe duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën deri në përfundimin e plotë të punimeve.
- Për impiantin e inerteve dhe të betonit duhet të paraqiten kontrata e blerjes ose e zhdoganimit, fotot ose fatura tatimore përkatëse, si dhe leja mjedisore e lëshuar nga QKL. Nëse është marrë me qira/furnizim, krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë/furnizimit. Operatori ekonomik, për fabrikën e inerteve dhe të betonit, mund të paraqesë edhe kontrata të vlefshme furnizimi me operatorë ekonomikë. Në këtë rast, duhet të paraqesë kontratën e furnizimit dhe dokumentacionin që vërteton ekzistencën dhe pronësinë e impiantit, si dhe lejen mjedisore me kod III.1.B, të lëshuar nga QKL.
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar, ku të jetë e dukshme edhe targa e mjetit.
- Makineritë e mësipërme nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata të tjera apo të deklaruar në procedura të shpallura fituese.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik, si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, „Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik“.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur bazuar në nenin 77, pika 1/c, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) dhe nenin 41, pika 4/ç të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), ku parashikohet se “*Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.*”.

Sipas preventivit, kontrata përfshin këto procese kryesore pastrimin e kanaleve, pastrimin e tombinove ekzistuese, pastrimin e vegjetacionit, pastrimin e karrexhatës nga aluvionet dhe materialet e tjera, mbushjen dhe profilimin e rrugëve të shtruara me çakull dhe mirëmbajtjen rutinë të veprave të artit.

Këto punime kanë karakter të ndryshëm teknik dhe kërkojnë përdorimin e makinerive të ndryshme, të përshtatura sipas natyrës së ndërhyrjes.

Për shkak të shtrirjes prej rreth 56 km, punimet nuk do të zhvillohen në një pikë të vetme dhe as në një kantier të vetëm të përqendruar, por në segmente të ndryshme të rrjetit rrugor. Për këtë arsye, operatori ekonomik duhet të ketë një kapacitet teknik të tillë që t'i mundësojë organizimin e punimeve sipas segmenteve dhe prioriteteve të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor.

Kërkesa për mjetet dhe pajisjet teknike synon të garantojë që operatori ekonomik të ketë kapacitetin real për:

- a) të realizuar njëkohësisht ose në mënyrë të koordinuar procese të ndryshme pune;
- b) të zhvendosë makineritë dhe materialet në segmente të ndryshme;
- c) të sigurojë furnizimin me materiale;
- d) të kryejë pastrimin dhe mirëmbajtjen e rrjetit rrugor;
- e) të realizojë punimet e mbushjes dhe profilimit;
- f) të ndërhyjë në kanale, tombino dhe vepra arti;
- g) të sigurojë ujitjen e materialeve dhe kontrollin e pluhurave gjatë punimeve;
- h) të përballojë punime të shpërndara në një periudhë 24-mujore.

Përcaktimi i sasive të mjeteve është bërë duke pasur parasysh nevojën për një kapacitet minimal operacional, duke shmangur një situatë ku një makineri e vetme do të duhej të mbulonte njëkohësisht procese të ndryshme pune ose segmente të ndryshme të rrjetit.

1. Mjet transporti vetëshkarkues mbi 8 ton – 3 copë

Kërkesa për 3 mjete transporti vetëshkarkuese mbi 8 ton lidhet drejtpërdrejt me proceset e pastrimit të kanaleve, pastrimit të tombinove, largimit të aluvioneve dhe materialeve të tjera, si dhe me transportin e materialeve të nevojshme për mbushjen dhe sistemimin e rrugëve.

Në proceset e pastrimit krijohen materiale të cilat duhet të ngarkohen, transportohen dhe largohen nga zona e punimeve. Ndërkohë, për mbushjen dhe profilimin e rrugëve të shtruara me çakull kërkohet transporti dhe furnizimi i vazhdueshëm me material.

Përcaktimi i 3 mjeteve synon të mundësojë një cikël transporti të vazhdueshëm dhe të reduktojë kohën e pritjes së makinerive të ngarkimit dhe të profilimit.

Duke pasur parasysh shtrirjen prej 56 km, distancat ndërmjet segmenteve të punës dhe nevojën për transport të materialeve në pika të ndryshme, disponimi i 3 mjeteve vetëshkarkuese përbën një kapacitet minimal të arsyeshëm për organizimin e punimeve.

2. Grejder – 1 copë

Grejderi është i nevojshëm veçanërisht për proceset e mbushjes dhe profilimit të rrugëve të shtruara me çakull.

Ky mjet mundëson nivelimin, shpërndarjen dhe profilimin e materialit, duke siguruar formimin e përshtatshëm të trupit të rrugës dhe përgatitjen e sipërfaqes për përfundimin e procesit të punës.

Duke qenë se në preventiv parashikohet shprehimisht procesi i mbushjes dhe profilimit të rrugëve, disponimi i një grejderi është i lidhur drejtpërdrejt me një nga proceset kryesore të kontratës.

3. Rrul vibrues – 1 copë

Rruli vibrues është i nevojshëm për ngjeshjen e materialeve pas mbushjes dhe profilimit të rrugëve.

Përdorimi i tij është i domosdoshëm për të arritur një stabilitet dhe densitet të përshtatshëm të shtresave të materialit dhe për të garantuar cilësinë dhe qëndrueshmërinë e ndërhyrjeve në rrugët e shtruara me çakull.

Kërkesa për 1 rrul vibrues është përcaktuar si kapacitet minimal teknik i nevojshëm për realizimin e procesit të ngjeshjes.

4. Betoniere – 1 copë

Betonierja lidhet me punimet e mundshme të mirëmbajtjes rutinë të veprave të artit, ku mund të kërkohej përdorimi i betonit për ndërhyrje dhe riparime të elementeve të ndryshme të veprave të artit. Disponimi i një betoniere siguron kapacitetin për të realizuar punime të tilla në terren, sipas nevojave konkrete që paraqiten gjatë zbatimit të kontratës.

5. Autobot uji – 1 copë

Autoboti i ujit është i nevojshëm për procese të ndryshme të zbatimit të punimeve, veçanërisht për lagështimin e materialeve gjatë punimeve të mbushjes dhe profilimit, si dhe për reduktimin e pluhurit në zonat ku zhvillohen punimet.

Duke qenë se punimet zhvillohen në një shtrirje prej rreth 56 km, autoboti i ujit mundëson furnizimin dhe përdorimin e ujit në mënyrë të organizuar në zonat e ndërhyrjes.

Kjo pajisje kontribuon si në cilësinë e procesit teknik të ngjeshjes së materialeve, ashtu edhe në menaxhimin e ndikimeve të punimeve në mjedisin përreth.

6. Motomjet ose agregatë për prerjen e bimësisë së ulët – 6 copë

Kërkesa për 6 motomjete ose agregatë për prerjen e bimësisë së ulët lidhet drejtpërdrejt me zërin e preventivit “Pastrimi i vegjetacionit”.

Duke pasur parasysh shtrirjen prej rreth 56 km, pastrimi i vegjetacionit mund të kërkojë ndërhyrje në segmente të ndryshme dhe organizimin e disa ekipeve pune. Disponimi i 6 pajisjeve krijon mundësinë e organizimit të punimeve në mënyrë të shpërndarë dhe të përshpejton procesin e pastrimit të vegjetacionit, pa e kufizuar realizimin e punimeve në një front të vetëm. Sasia e përcaktuar synon të sigurojë kapacitet minimal operacional për punimet e pastrimit të vegjetacionit përgjatë një rrjeti të gjatë rrugor.

7. Kamionçinë deri në 3.5 ton – 3 copë

Kamionçinat janë të nevojshme për transportin e personelit, veglave të punës, pajisjeve të vogla, materialeve të lehta dhe mjeteve të nevojshme për ndërhyrje në segmente të ndryshme.

Për shkak të shtrirjes prej 56 km dhe organizimit të punimeve në zona të ndryshme, 3 kamionçina krijojnë mundësinë e lëvizjes së ekipeve dhe mjeteve të nevojshme në mënyrë të pavarur dhe të

koordinuar. Ato janë veçanërisht të dobishme për punimet rutinë dhe ndërhyrjet e shpejta në segmente të ndryshme të rrjetit.

8. Minieskavator – 2 copë

Minieskavatorët janë të nevojshëm për punime në zona ku makineritë e mëdha kanë vështirësi akses. Në veçanti, ato mund të përdoren për pastrimin e kanaleve dhe tombinove, ndërhyrjet në zona të kufizuara dhe punime të tjera ku kërkohet manovrim i lartë. Disponimi i 2 minieskavatorëve mundëson organizimin e punimeve në dy fronte të ndryshme ose përdorimin e njëkohshëm në segmente të ndryshme të rrjetit.

9. Minifadromë (Bobcat ose ekuivalent) – 2 copë

Minifadromat janë të nevojshme për ngarkimin, zhvendosjen dhe sistemimin e materialeve në zona të ndryshme të punimeve. Ato janë veçanërisht të përshtatshme për punime në hapësira të kufizuara dhe për procese ku kërkohet manovrim i shpejtë. Disponimi i 2 mjeteve siguron fleksibilitet operacional dhe mundësi për ndërhyrje në më shumë se një segment të objektit.

10. Ekskavator me goma – 2 copë

Ekskavatorët me goma lidhen drejtpërdrejt me punimet e pastrimit të kanaleve, tombinove dhe materialeve të depozituara, si dhe me punime të tjera të nevojshme për sistemimin e rrugëve dhe veprave të artit. Avantazhi i ekskavatorit me goma lidhet me mundësinë e lëvizjes më të shpejtë ndërmjet segmenteve të ndryshme të rrjetit rrugor, pa qenë i nevojshëm transporti i tij i vazhdueshëm me mjete të posaçme. Përcaktimi i 2 ekskavatorëve lidhet me shtrirjen prej 56 km dhe nevojën për të mundësuar ndërhyrje në segmente të ndryshme.

11. Traktor i pajisur me agregat për prerjen e bimësisë – 1 copë

Ky mjet lidhet drejtpërdrejt me procesin e pastrimit të vegjetacionit. Përdorimi i traktorit me agregat për prerjen e bimësisë mundëson realizimin e punimeve në sipërfaqe më të gjera dhe në segmente ku kërkohet kapacitet më i lartë pune. Ky mjet plotëson pajisjet e tjera për prerjen e bimësisë dhe mundëson organizimin më efikas të procesit të pastrimit.

12. Fabrikë për prodhimin dhe furnizimin me inerte dhe beton – 1 copë

Kërkesa për disponimin e një fabrike për prodhimin dhe furnizimin me inerte dhe beton, në pronësi, me qira ose nëpërmjet kontratës së furnizimit, lidhet me nevojën për të garantuar furnizimin e vazhdueshëm dhe të kontrolluar me materiale të nevojshme për realizimin e punimeve. Kërkesa është përcaktuar në mënyrë fleksibël, duke lejuar që operatori ekonomik ta disponojë impiantin në pronësi, me qira ose nëpërmjet kontratës së furnizimit. Kjo mënyrë garanton që kriteri të mos kufizojë pjesëmarrjen vetëm të operatorët ekonomikë që kanë impiantin në pronësi, por të pranojë edhe forma të tjera të ligjshme të disponimit të kapaciteteve. Kërkesa për dokumentacionin përkatës të impiantit dhe lejet mjedisore synon të garantojë që furnizimi me materiale të kryhet nga një burim real, i identifikueshëm dhe në përputhje me kërkesat ligjore dhe mjedisore.

Sasitë e mjeteve të përcaktuara në kriter nuk janë vendosur në mënyrë arbitrare, por janë përcaktuar në funksion të organizimit të punimeve në një rrjet me gjatësi rreth 56 km. Në veçanti:

- 3 mjete vetëshkarkuese kërkohen për sigurimin e transportit të materialeve dhe largimin e materialeve të pastrimit;
- 1 grejder kërkohet për profilimin e rrugëve;
- 1 rrul vibruës kërkohet për ngjeshjen e shtresave;
- 1 betoniere kërkohet për punime të lidhura me mirëmbajtjen e veprave të artit;
- 1 autobot uji kërkohet për proceset e lagështimit dhe kontrollit të pluhurit;

- 6 motomjete/agregatë për prerje kërkohen për organizimin e disa ekipeve në pastrimin e vegjetacionit;
- 3 kamionçina kërkohen për transportin e ekipeve, mjeteve dhe materialeve të vogla;
- 2 minieskavatorë kërkohen për ndërhyrje në zona të kufizuara dhe segmente të ndryshme;
- 2 minifadroma kërkohen për ngarkim dhe zhvendosje materiale;
- 2 ekskavatorë me goma kërkohen për punimet e pastrimit dhe ndërhyrjet në segmente të ndryshme;
- 1 traktor me agregat kërkohet për pastrimin e mekanizuar të bimësisë;
- 1 impiant furnizimi me inerte dhe beton kërkohet për garantimin e furnizimit me materialet e nevojshme.

Në tërësi, kjo flotë synon të krijojë kapacitetin minimal teknik për realizimin e punimeve të parashikuara në preventiv, duke i dhënë operatorit ekonomik mundësinë të organizojë punimet sipas segmenteve dhe të sigurojë vijueshmërinë e tyre gjatë periudhës 24-mujore.

Shtrirja prej rreth 56 km është një faktor përcaktues në dimensionimin e kapaciteteve teknike.

Në një kontratë të kësaj natyre, makineritë nuk do të përdoren domosdoshmërisht në një pikë të vetme, por do të duhet të zhvendosen dhe angazhohen në segmente të ndryshme të rrjetit. Për këtë arsye, kërkesa për disponimin e mjeteve të caktuara në sasi minimale synon të shmangë situatën ku operatori ekonomik do të kishte vetëm një numër tepër të kufizuar makinerish dhe do të ishte i detyruar të përfundonte një proces pune në një segment përpara se të mund të ndërhynte në një segment tjetër. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për punimet e pastrimit të vegjetacionit, pastrimit të kanaleve dhe tombinove, si dhe për pastrimin e karrexhatës, të cilat mund të kërkojnë ndërhyrje në segmente të ndryshme.

Kohëzgjatja prej 24 muajsh kërkon që operatori ekonomik të ketë kapacitet të qëndrueshëm teknik gjatë gjithë periudhës së kontratës.

Punimet e mirëmbajtjes dhe sistemimit të rrugëve bujqësore kanë karakter të vazhdueshëm dhe mund të kërkojnë ndërhyrje të përsëritura në segmente të ndryshme.

Për këtë arsye, disponimi i mjeteve dhe pajisjeve në nivelin minimal të përcaktuar është i nevojshëm për të garantuar që operatori ekonomik të mund të përballojë nevojat teknike të kontratës gjatë gjithë periudhës së zbatimit.

Kriteri lejon që mjetet të disponohen në pronësi ose me qira, ndërsa për impiantin lejon edhe kontratën e furnizimit. Kjo qasje është përcaktuar me qëllim që kërkesa të jetë proporcionale dhe të mos kufizojë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë vetëm te subjektet që kanë në pronësi të gjithë flotën e makinerive. Në këtë mënyrë, operatorët ekonomikë mund të dëshmojnë kapacitetin e tyre teknik edhe nëpërmjet burimeve që u vihen në dispozicion nëpërmjet marrëdhënieve të ligjshme të qirasë ose furnizimit. Kërkesa që kontratat e qirasë të jenë të vlefshme për gjithë periudhën deri në përfundimin e plotë të punimeve synon të garantojë që mjetet dhe pajisjet do të jenë realisht të disponueshme gjatë gjithë periudhës së nevojshme për zbatimin e kontratës.

Kërkesa që makineritë e deklaruar të mos jenë të angazhuara në kontrata të tjera ose të deklaruar në procedura të shpallura fituese synon të garantojë disponueshmërinë reale dhe efektive të kapaciteteve teknike.

Një mjet i deklaruar për realizimin e kontratës duhet të jetë realisht i disponueshëm për përdorim dhe nuk duhet të konsiderohet njëkohësisht si kapacitet teknik i dedikuar për kontrata të tjera, nëse kjo do të pengonte përdorimin e tij për objektin e prokurimit.

Kjo kërkesë synon të parandalojë deklarin formal të të njëjtit mjet në disa kontrata, pa pasur kapacitet real për ta vënë atë në dispozicion të të gjitha kontratave.

Kërkesa për paraqitjen e dokumenteve që provojnë pronësinë, qiranë, ekzistencën dhe gjendjen e mjeteve synon të garantojë verifikimin objektiv të kapacitetit teknik të deklaruar.

Dokumentacioni i kërkuar, sipas llojit të mjetit, shërben për të verifikuar ekzistencën reale të mjetit, identifikimin e tij, pronësinë ose të drejtën e përdorimit, vlefshmërinë e dokumentacionit dhe disponueshmërinë e tij për periudhën e zbatimit të kontratës. Kërkesa për paraqitjen e fotove të mjeteve synon të ndihmojë në identifikimin fizik të tyre dhe në verifikimin e përputhjes së mjetit të deklaruar me dokumentacionin e paraqitur. Autoriteti Kontraktor ruan të drejtën të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar dhe të kërkojë sqarime ose dokumente mbështetëse në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

Kriteri konsiderohet i përmbushur në fazën e parë të procedurës me paraqitjen e Formularit të Vetëdeklarimit. Dokumentet provuese kërkohe nga ofertuesi i kualifikuar, me qëllim që Autoriteti Kontraktor të verifikojë në mënyrë të plotë dhe objektive disponimin real të mjeteve dhe pajisjeve të deklaruara.

Kjo mënyrë verifikimi siguron një ekuilibër ndërmjet nevojës për verifikim të kapacitetit teknik dhe parimit të efikasitetit të procedurës së prokurimit.

2.3.9 Operatori/ët ekonomik/ë duhet të paraqesin certifikatat e cilësisë së punimeve, të vlefshme (ose ekuivalente) për objektin që prokurohet, si më poshtë:

- ISO 9001 – Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë ose ekuivalente;
- ISO 14001 – Sistemet e Menaxhimit Mjedisor ose ekuivalente;
- ISO 45001 – Sistemet e Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në Punë ose ekuivalente.

Të gjitha certifikatat e mësipërme duhet të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatën e mësipërme, sipas zërave që do të realizojë.

Argumentimi: Kjo kërkesë është në përputhje me pikën 1 të nenit 79 të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se: “1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatat të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.”. Ky kriter gjen mbështetje në pikën 1 të nenit 44 të VKM nr. 285 date 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” ku përcaktohet se: “1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.”

Kërkesa për disponimin e certifikatave të sistemeve të menaxhimit të cilësisë, mjedisit dhe shëndetit e sigurisë në punë është përcaktuar në funksion të natyrës së objektit të prokurimit dhe nevojës së Autoritetit Kontraktor për të garantuar që operatori ekonomik që do të zbatojë kontratën disponon një

sistem të organizuar menaxhimi për kontrollin e proceseve të punës, menaxhimin e ndikimeve mjedisore dhe administrimin e rreziqeve që lidhen me sigurinë dhe shëndetin në punë.

Kriteri mbështetet në kuadrin ligjor të prokurimit publik që i lejon Autoritetit Kontraktor të kërkojë dëshmi për kapacitetet teknike dhe profesionale dhe për zbatimin e standardeve të sigurimit të cilësisë, të menaxhimit mjedisor dhe të sigurisë e shëndetit në punë, për aq sa këto kërkesa janë të lidhura me objektin e kontratës dhe janë proporcionale me natyrën, kompleksitetin dhe volumnin e saj.

Në përcaktimin e këtij kriteri është mbajtur parasysh se kërkesat për certifikime nuk synojnë të kufizojnë pjesëmarrjen në procedurë, por të garantojnë që operatori ekonomik i përzgjedhur të disponojë një sistem të dokumentuar dhe të verifikueshëm për menaxhimin e proceseve që do të kryhen gjatë zbatimit të kontratës.

Pranimi i certifikatave ekuivalente synon të garantojë respektimin e parimit të konkurrencës dhe të mos kufizojë pjesëmarrjen vetëm te operatorët ekonomikë që disponojnë certifikata me një emërtim të caktuar, për sa kohë që dokumentacioni ekuivalent provon se operatori ekonomik zbaton sisteme menaxhimi me objekt dhe standarde të krahasueshme.

Sipas preventivit, kontrata përfshin procese të ndryshme pune, ndër të cilat pastrimin e kanaleve, pastrimin e tombinove ekzistuese, pastrimin e vegjetacionit, pastrimin e karrexhatës nga aluvionet dhe materialet e tjera, mbushjen dhe profilimin e rrugëve të shtruara me çakull, mirëmbajtjen rutinë të veprave të artit.

Këto punime do të realizohen në terren dhe në segmente të ndryshme të rrjetit rrugor, duke kërkuar organizim të vazhdueshëm të burimeve njerëzore dhe teknike, përdorim të makinerive, transport të materialeve dhe menaxhim të proceseve që mund të ndikojnë në cilësinë e punimeve, në mjedisin përreth dhe në sigurinë e punonjësve.

Për këtë arsye, Autoriteti Kontraktor e konsideron të nevojshme që operatori ekonomik të dëshmojë se disponon një sistem të organizuar menaxhimi që mbulon këto tri fusha kryesore:

1. menaxhimin dhe kontrollin e cilësisë së punimeve;
2. menaxhimin dhe kontrollin e ndikimeve mjedisore;
3. menaxhimin e sigurisë dhe shëndetit në punë.

Këto tri fusha janë të lidhura drejtpërdrejt me proceset që do të zhvillohen gjatë zbatimit të kontratës dhe me përgjegjësinë e operatorit ekonomik për realizimin e punimeve sipas kërkesave teknike dhe kontraktore.

Kërkesa për disponimin e certifikatës ISO 9001 ose ekuivalente lidhet me nevojën për të garantuar që operatori ekonomik disponon një sistem të dokumentuar për menaxhimin dhe kontrollin e cilësisë së proceseve të punës.

Punimet e parashikuara në kontratë kërkojnë kontroll të vazhdueshëm të proceseve dhe rezultateve të tyre.

Në veçanti, punimet e mbushjes së rrugëve, profilimit të rrugëve të shtruara me çakull, ngjeshjes së materialeve, pastrimit të kanaleve dhe tombinove dhe mirëmbajtjes së veprave të artit duhet të realizohen në përputhje me specifikimet teknike, kërkesat e projektit, preventivin dhe kushtet kontraktore.

Për shembull, në rastin e punimeve të mbushjes dhe profilimit të rrugëve, cilësia e rezultatit përfundimtar varet nga kontrolli i materialeve të përdorura, mënyra e shpërndarjes, profilimi dhe ngjeshja e tyre.

Një sistem i menaxhimit të cilësisë krijon një kuadër të organizuar për:

- a) planifikimin e proceseve të punës;

- b) përcaktimin e përgjegjësisë;
- c) kontrollin e proceseve;
- d) dokumentimin dhe gjurmueshmërinë;
- e) identifikimin e mospërputhjeve;
- f) marrjen e masave korrigjuese;
- g) monitorimin e rezultateve.

Duke pasur parasysh se kontrata ka kohëzgjatje 24 muaj dhe shtrihet në rreth 56 km, garantimi i një sistemi të qëndrueshëm të menaxhimit të cilësisë është i rëndësishëm për të siguruar që punimet të realizohen në mënyrë të njëtrajtshme dhe të kontrolluar gjatë gjithë periudhës së kontratës dhe në të gjitha segmentet e objektit.

Për këtë arsye, certifikimi ISO 9001 ose ekuivalent konsiderohet i lidhur drejtpërdrejt me objektin e prokurimit dhe me nevojën për të garantuar cilësinë e punimeve.

Kërkesa për disponimin e certifikatës ISO 14001 ose ekuivalente lidhet me natyrën e punimeve dhe ndikimet e mundshme që aktivitetet e zbatimit të kontratës mund të kenë në mjedisin përreth. Kontrata parashikon ndërhyrje në një rrjet rrugor me gjatësi rreth 56 km, ku përfshihen punime në kanale, tombino, karrexhata, sipërfaqe me vegjetacion dhe zona të ndryshme të territorit.

Proceset e punës mund të shoqërohen me:

- a) gjenerimin dhe largimin e materialeve të pastrimit;
- b) mbetje të ndryshme të krijuara gjatë punimeve;
- c) ndërhyrje në vegjetacion;
- d) emetime pluhuri gjatë punimeve;
- e) zhurma nga përdorimi i makinerive;
- f) përdorimin e karburanteve dhe lubrifikantëve;
- g) transportin e materialeve;
- h) ndikime të përkohshme në zonat ku zhvillohen punimet.

Në këtë kuadër, disponimi i një sistemi të menaxhimit mjedisor synon të garantojë që operatori ekonomik të ketë një qasje të organizuar për identifikimin, kontrollin dhe reduktimin e ndikimeve mjedisore që lidhen me aktivitetet e tij.

ISO 14001 ose ekuivalenti i saj shërben si dëshmi se operatori ekonomik ka krijuar një sistem menaxhimi për çështjet mjedisore, duke përfshirë identifikimin e aspekteve mjedisore, përcaktimin e masave të kontrollit dhe monitorimin e performancës mjedisore.

Kjo kërkesë është veçanërisht e lidhur me zërat e preventivit që kanë të bëjnë me pastrimin e kanaleve, pastrimin e tombinove, pastrimin e vegjetacionit dhe largimin e materialeve të ndryshme nga karrexhata. Duke pasur parasysh shtrirjen e gjerë të kontratës dhe kohëzgjatjen 24-mujore, menaxhimi i ndikimeve mjedisore duhet të jetë një proces i vazhdueshëm gjatë gjithë zbatimit të kontratës.

Për këtë arsye, kërkesa për ISO 14001 ose ekuivalente konsiderohet e lidhur me objektin e prokurimit dhe proporcionale me natyrën dhe shtrirjen e punimeve.

Kërkesa për disponimin e certifikatës ISO 45001 ose ekuivalente lidhet me nevojën për të garantuar menaxhimin sistematik të rreziqeve të sigurisë dhe shëndetit në punë gjatë zbatimit të kontratës.

Punimet objekt kontrate do të realizohen në terren, përgjatë një shtrirjeje prej rreth 56 km, dhe do të përfshijnë përdorimin e makinerive dhe pajisjeve të ndryshme.

Punimet e pastrimit të kanaleve dhe tombinove, pastrimit të vegjetacionit, pastrimit të karrexhatës dhe mbushjes e profilimit të rrugëve mund të përfshijnë përdorimin e ekskavatorëve,

minieskavatorëve, minifadromave, grejderëve, mjeteve vetëshkarkuese, rrulave vibrues, mjeteve për prerjen e bimësisë, traktorëve dhe pajisjeve të tjera.

Përdorimi i këtyre makinerive dhe organizimi i punimeve në segmente të ndryshme krijon nevojën për një sistem të organizuar të identifikimit dhe menaxhimit të rreziqeve.

Kërkesa për ISO 45001 ose ekuivalente synon të garantojë që operatori ekonomik disponon një sistem të strukturuar për:

- a) identifikimin e rreziqeve;
- b) vlerësimin e riskut;
- c) përcaktimin e masave parandaluese;
- d) trajnimin dhe ndërgjegjësimin e punonjësve;
- e) kontrollin e kushteve të punës;
- f) monitorimin e incidenteve;
- g) përmirësimin e vazhdueshëm të performancës së sigurisë.

Kjo kërkesë lidhet gjithashtu me kriterin e kualifikimit për disponimin e personelit të specializuar në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë, pasi të dyja kërkesat plotësojnë njëra-tjetrën.

Ndërsa personeli i specializuar siguron kompetencën profesionale dhe përgjegjësinë për menaxhimin e sigurisë në terren, sistemi i menaxhimit ISO 45001 siguron një kuadër të organizuar për planifikimin, zbatimin, monitorimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të proceseve të sigurisë.

Kërkesa që certifikatat të jenë të vlefshme në momentin e paraqitjes synon të garantojë që sistemi i menaxhimit i deklaruar nga operatori ekonomik është aktiv dhe funksional.

Një certifikatë e skaduar nuk mund të shërbejë në të njëjtën masë si dëshmi e një sistemi menaxhimi aktual dhe të zbatueshëm. Për këtë arsye, vlefshmëria e certifikatave lidhet drejtpërdrejt me nevojën e Autoritetit Kontraktor për të siguruar që operatori ekonomik i përzgjedhur ka një sistem menaxhimi aktiv në momentin e konkurrimit dhe të realizimit të kontratës.

Kërkesa që certifikatat të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, synon të garantojë besueshmërinë dhe verifikueshmërinë e certifikimeve të paraqitura. Kjo kërkesë siguron që certifikimi të mos jetë vetëm një deklaram formal i operatorit ekonomik, por të jetë rezultat i një procesi vlerësimi dhe certifikimi të kryer nga një subjekt kompetent dhe i njohur sipas kërkesave të akreditimit.

Në këtë mënyrë, Autoriteti Kontraktor mund të sigurohet se certifikatat e paraqitura janë të besueshme dhe se sistemi i menaxhimit i deklaruar nga operatori ekonomik është vlerësuar nga një subjekt kompetent.

Përcaktimi i shprehjes “ose ekuivalente” është bërë me qëllim që kërkesa të mos kufizojë konkurrencën dhe të mos favorizojë një certifikim të vetëm apo një subjekt të caktuar certifikues.

Në këtë mënyrë, operatorët ekonomikë që disponojnë sisteme menaxhimi të certifikuar sipas standardeve të tjera të njohura dhe që ofrojnë garanci të barasvlershme me kërkesat e ISO 9001, ISO 14001 dhe ISO 45001, mund të provojnë përmbushjen e kriterit nëpërmjet dokumentacionit ekuivalent. Pranimi i ekuivalencës synon të respektojë parimet e konkurrencës, transparencës dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë.

Në rastin e Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë, kërkesa që çdo anëtar të paraqesë certifikatat përkatëse sipas zërave të punimeve që do të realizojë është përcaktuar me qëllim që kapaciteti i dëshmuar përmes certifikimeve të jetë i lidhur drejtpërdrejt me aktivitetin konkret që secili anëtar merr përsipër të realizojë. Në këtë mënyrë, nëse një anëtar i bashkimit angazhohet për realizimin e

një pjese të caktuar të punimeve, certifikimet e tij duhet të mbulojnë aktivitetet dhe proceset përkatëse që ai do të realizojë. Ky formulim synon të garantojë që çdo pjesë e kontratës të mbullohet nga operatori ekonomik që disponon sistemet përkatëse të menaxhimit për fushën e aktivitetit që ka marrë përsipër. Nga ana tjetër, ky përcaktim shmang kërkesën që çdo anëtar i Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë të disponojë domosdoshmërisht të gjitha certifikatat, nëse ai nuk do të realizojë të gjithë zërat e punimeve. Për rrjedhojë, kërkesa zbatohet në mënyrë të lidhur me ndarjen konkrete të detyrave dhe punimeve ndërmjet anëtarëve të bashkimit, duke respektuar parimin e proporcionalitetit.

Tre certifikimet e kërkuara mbulojnë fusha të ndryshme të menaxhimit dhe janë plotësuese:

- ISO 9001 lidhet me garantimin dhe kontrollin e cilësisë së proceseve dhe rezultateve të punimeve;
- ISO 14001 lidhet me menaxhimin dhe kontrollin e ndikimeve mjedisore;
- ISO 45001 lidhet me menaxhimin e rreziqeve të sigurisë dhe shëndetit në punë.

Për shkak se kontrata ka natyrë shumëdimensionale, kërkesa për të tria sistemet e menaxhimit është e lidhur me tri komponentë të rëndësishëm të realizimit të saj.

Këto sisteme janë veçanërisht të rëndësishme në një kontratë që:

- a) shtrihet në rreth 56 km;
- b) zbatohet për një periudhë 24-mujore;
- c) zhvillohet në segmente të ndryshme të territorit;
- d) përfshin përdorimin e makinerive të rënda;
- e) përfshin transport dhe përdorim të materialeve;
- f) përfshin pastrimin e kanaleve dhe tombinove;
- g) përfshin pastrimin e vegjetacionit;
- h) përfshin ndërhyrje në rrugë dhe vepra arti;
- i) mund të ketë ndikime në mjedis;
- j) kërkon menaxhim të vazhdueshëm të sigurisë dhe shëndetit të punonjësve.

Për këtë arsye, kërkesa për këto tri certifikime konsiderohet e lidhur me objektin dhe e përshtatshme për të siguruar një nivel të arsyeshëm të kapacitetit organizativ të operatorit ekonomik.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Njësia e Prokurimit, në kuadër të përgatitjes së dokumentacionit të procedurës së prokurimit me objekt “Sistemimi i rrugëve bujqësore në territorin e Bashkisë Himarë”, pas shqyrtimit të nevojave të Autoritetit Kontraktor, gjendjes së rrjetit ekzistues të rrugëve bujqësore dhe rurale, karakteristikave të territorit ku shtrihet ky rrjet, si dhe nevojës për garantimin e aksesueshmërisë dhe funksionalitetit të tij gjatë gjithë periudhës së kontratës, vlerëson se specifikimet teknike të hartuara janë të nevojshme, të arsyeshme dhe të përshtatshme për realizimin e objektit të prokurimit.

Hartimi i specifikimeve teknike është bërë duke u bazuar në nevojën konkrete të Bashkisë Himarë për të garantuar mirëmbajtjen dhe funksionalitetin e rrugëve bujqësore ekzistuese në territorin administrativ të saj. Rrjeti rrugor që përfshihet në objektin e shërbimit ka një gjatësi totale orientuese prej rreth 54,600 metrash, ose 54.60 km, dhe shtrihet kryesisht në zonat rurale të Nivicës, Shën Vasilit, Lukovës, Piqerasit, Borshit, Qeparoit dhe zonave të tjera rurale përreth. Rrugët objekt i këtij shërbimi kanë karakteristika tipike të rrugëve bujqësore dhe rurale, me gjerësi që varion në mënyrë orientuese nga 3.00 m deri në 4.00 m dhe me gjerësi mesatare rreth 3.50 m. Këto rrugë shërbejnë kryesisht për lidhjen dhe aksesin e tokave bujqësore, ullishteve, pemëtoreve, kullotave dhe zonave të banuara

rurale, si dhe për lëvizjen e mjeteve bujqësore, mjeteve të banorëve dhe, në raste të caktuara, mjeteve që përdoren për shërbime publike dhe emergjenca.

Nga analiza e kushteve ekzistuese dhe e karakteristikave të territorit është konstatuar se një pjesë e konsiderueshme e këtyre rrugëve kërkon ndërhyrje sistemimi, rehabilitimi lokal dhe mirëmbajtjeje të vazhdueshme. Rrugët janë krijuar dhe përdorur prej vitesh dhe, për shkak të mungesës së mirëmbajtjes së vazhdueshme, ekspozimit ndaj reshjeve atmosferike, rrjedhjeve sipërfaqësore, erozionit, lëvizjes së materialeve nga shpatet dhe zhvillimit të pakontrolluar të vegjetacionit, paraqesin dëmtime të ndryshme që ndikojnë drejtpërdrejt në funksionalitetin dhe kalueshmërinë e tyre.

Në segmente të ndryshme të rrjetit janë evidentuar dëmtime ose humbje të shtresës ekzistuese të çakullit, krijim gropash, ulje dhe deformime të sipërfaqes së rrugës, depozitime dherash dhe materialesh aluvionale, ngushtim i trupit të rrugës për shkak të rritjes së shkurreve dhe vegjetacionit, mbulim i pjesëve të rrugës nga bimësia, dëmtime ose bllokime të kanaleve anësore, bllokime të tombinove ekzistuese, mungesë e disiplinimit të ujërave dhe dëmtime të shkaktuara nga rrjedhjet sipërfaqësore. Këto problematika, nëse nuk trajtohen në mënyrë periodike dhe të organizuar, mund të sjellin përkeqësim progresiv të gjendjes së rrugëve, duke shkaktuar ndërprerje të kalueshmërisë, dëmtime më të mëdha të trupit të rrugës dhe rritje të kostove të ndërhyrjeve në të ardhmen.

Në këto kushte, Njësia e Prokurimit vlerëson se shërbimi i kërkuar duhet të konceptohet si një ndërhyrje e integruar që përfshin sistemimin fillestar të rrjetit, rehabilitimin lokal të segmenteve të dëmtuara, mirëmbajtjen rutinë dhe ndërhyrjet emergjente gjatë gjithë periudhës së kontratës. Kjo mënyrë organizimi është teknikisht e nevojshme, pasi gjendja e rrugëve bujqësore ndryshon në mënyrë të vazhdueshme nën ndikimin e kushteve atmosferike dhe përdorimit të tyre. Në veçanti, reshjet intensive mund të shkaktojnë dëmtime të menjëhershme të shtresës së rrugës, bllokim të tombinove, mbushje të kanaleve me materiale të ngurta, depozitime në sipërfaqen e rrugës dhe rrëshqitje lokale të materialeve nga shpatet. Për këtë arsye, mirëmbajtja nuk mund të konsiderohet si një ndërhyrje e vetme në fillim të kontratës, por duhet të jetë një proces i vazhdueshëm dhe proaktiv gjatë gjithë periudhës 24-mujore.

Specifikimet teknike përcaktojnë se shërbimi do të realizohet mbi gjurmët ekzistuese të rrugëve bujqësore dhe nuk parashikon hapjen e trasesë së re. Ky përcaktim është bërë me qëllim që ndërhyrjet të kufizohen në rikthimin dhe përmirësimin e funksionalitetit të infrastrukturës ekzistuese, duke shmangur ndërhyrjet e panevojshme në prona private, parcela bujqësore, sipërfaqe të gjelbra dhe elemente të tjera të territorit që ndodhen jashtë zonës së nevojshme të ndërhyrjes. Ndërhyrjet lokale që mund të rezultojnë të nevojshme do të kryhen vetëm në funksion të sistemimit të trupit ekzistues të rrugës, stabilizimit të segmenteve të dëmtuara, përmirësimit të kullimit dhe rikthimit të kalueshmërisë.

Përcaktimi i shërbimit të pastrimit dhe shkurtimit të vegjetacionit është bërë duke marrë në konsideratë faktin se zhvillimi i bimësisë përgjatë rrugëve rurale përbën një nga faktorët që ndikon drejtpërdrejt në reduktimin e gjerësisë funksionale të rrugës dhe në vështirësimin e qarkullimit të mjeteve. Në disa segmente, shkurret, degët dhe bimësia mund të pengojnë lëvizjen e mjeteve, të kufizojnë shikueshmërinë dhe të vështirësojnë aksesin në raste emergjence. Për këtë arsye, specifikimet teknike parashikojnë pastrimin e trupit të rrugës, bankinave dhe anëve të saj, prerjen e shkurreve dhe degëve penguese, trajtimin e bimëve të vogla dhe largimin e materialit bimor të krijuar gjatë ndërhyrjes. Këto punime do të kufizohen vetëm në masën e nevojshme për funksionimin normal të rrugës dhe nuk do të shtrihen në zona jashtë nevojës së ndërhyrjes.

Përcaktimi i punimeve të gërmimit dhe sistemimit është i lidhur me nevojën për të trajtuar dëmtimet e krijuara në trupin e rrugës nga reshjet, erozioni, depozitimet aluvionale dhe rrjedhjet sipërfaqësore. Gërmimet dhe sistemimet do të kryhen në mënyrë të kontrolluar, me qëllim që të mos shkaktohet destabilizimi i skarpatave dhe të mos dëmtohen parcelat përreth. Në rastet kur gjatë punimeve rezultojnë materiale të papërshtatshme, ato do të largohen dhe transportohen në vende të përshtatshme dhe të miratuara, duke respektuar kërkesat për mbrojtjen e mjedisit dhe udhëzimet e Autoritetit Kontraktor dhe Mbikëqyrësit të Shërbimit.

Sistemimi i trupit të rrugës është përcaktuar si një element i domosdoshëm i ndërhyrjes, pasi një sipërfaqe e deformuar, e mbushur me gropa dhe me ulje lokale nuk siguron kalueshmëri të përshtatshme dhe favorizon grumbullimin e ujërave. Për këtë arsye, specifikimet teknike parashikojnë nivelimin, eliminimin e deformimeve, mbushjen e gropave, rregullimin e uljeve lokale dhe profilimin e sipërfaqes. Këto ndërhyrje synojnë të krijojnë një profil funksional të rrugës, të përshtatur me terrenin ekzistues, duke siguruar që ujërat e reshjeve të largohen nga sipërfaqja e rrugës dhe të mos krijojnë dëmtime të reja.

Përcaktimi i shtresës orientuese të çakullit me trashësi rreth 20 cm dhe gjerësi mesatare orientuese rreth 3.50 m është bërë në funksion të karakteristikave të rrugëve bujqësore ekzistuese dhe nevojës për rikthimin e një sipërfaqeje të qëndrueshme dhe të kalueshme. Kjo shtresë do të aplikohet në segmentet ku shtresa ekzistuese është dëmtuar ose mungon dhe do të realizohet nëpërmjet furnizimit, shpërndarjes, nivelimit, profilimit dhe ngjeshjes së materialit granular. Përcaktimi i trashësisë bëhet si orientues dhe kontrolli i saj do të kryhet pas ngjeshjes, duke garantuar që shtresa përfundimtare të ketë profilin dhe qëndrueshmërinë e kërkuar për përdorimin e rrugës.

Njësia e Prokurimit vlerëson se për shkak të karakteristikave të territorit të Bashkisë Himarë, disiplinimi i ujërave sipërfaqësore është një nga komponentët kryesorë të shërbimit. Terreni kodrinor dhe malor, pjerrësitë e ndryshme të rrugëve dhe intensiteti i reshjeve mund të krijojnë rrjedhje të përqendruara që dëmtojnë sipërfaqen e rrugës dhe skarpatat. Për këtë arsye, specifikimet teknike parashikojnë pastrimin, hapjen dhe riformimin e kanaleve anësore, duke siguruar rrjedhje të lirë të ujërave dhe duke shmangur përqendrimin e tyre mbi trupin e rrugës.

Në të njëjtën mënyrë, pastrimi, mirëmbajtja dhe funksionalizimi i tombinove janë të domosdoshme për garantimin e vazhdimësisë së rrjedhjeve të ujërave dhe mbrojtjen e trupit të rrugës. Në pikat ku tombinot ekzistuese janë të dëmtuara ose ku mungojnë, specifikimet parashikojnë mundësinë e furnizimit dhe vendosjes së tubave HDPE SN8 me diametra orientues Ø315 mm, Ø500 mm dhe Ø800 mm. Këto diametra janë përcaktuar si orientues, ndërsa përzgjedhja konkrete do të bëhet në varësi të kushteve reale të terrenit, sasisë dhe drejtimit të rrjedhjes së ujërave dhe nevojave teknike të çdo pike. Ky përcaktim është i arsyeshëm pasi kushtet e rrjedhjes nuk janë të njëjta në të gjithë gjatësinë e rrjetit dhe kërkohet një përshtatje e ndërhyrjes me situatën faktike në terren.

Parashikimi i strukturave prej betoni C12/15 dhe C20/25 është bërë për të mundësuar realizimin e ndërhyrjeve të nevojshme në pikat ku kërkohet mbrojtja e tombinove, stabilizimi i segmenteve të rrugës ose mbrojtja nga erozioni. Këto struktura nuk parashikohen si ndërtime të përgjithshme përgjatë gjithë rrjetit, por si ndërhyrje lokale të kushtëzuara nga nevojat faktike të identifikuar gjatë inspektimeve dhe gjatë zbatimit të shërbimit. Kjo qasje siguron që ndërhyrjet të jenë proporcionale me problematikën reale dhe të realizohen vetëm në ato pika ku kërkohet ndërhyrje teknike.

Për shkak të gjatësisë prej 54.60 km të rrjetit dhe shpërndarjes së tij në një territor të gjerë, është e nevojshme që shërbimi të organizohet në fronte të ndryshme ndërhyrjeje dhe sipas prioriteteve të përcaktuara nga gjendja faktike e rrugëve. Në këtë kuadër, kontraktori duhet të kryejë fillimisht një

inspektim të plotë të zonës së ndërhyrjes, të identifikojë segmentet problematike dhe të përcaktojë, në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktor dhe Mbikëqyrësin e Shërbimit, mënyrën dhe radhën e ndërhyrjeve. Kjo mënyrë organizimi është e nevojshme për të garantuar përdorimin racional të burimeve njerëzore dhe teknike dhe për të siguruar që segmentet me problematika më të mëdha të trajtohen në kohë.

Përcaktimi i periudhës së mirëmbajtjes prej 24 muajsh është i lidhur me nevojën për të garantuar funksionalitetin e rrjetit në një periudhë të mjaftueshme kohore dhe për të përfshirë cikle të ndryshme sezonale dhe kushtet e ndryshme atmosferike që mund të ndikojnë në gjendjen e rrugëve. Në kushtet e territorit të Bashkisë Himarë, reshjet intensive dhe fenomenet e erozionit mund të ndikojnë në mënyrë të përsëritur në rrjetin e rrugëve rurale. Për këtë arsye, një periudhë e kufizuar vetëm në ndërhyrjen fillestare nuk do të garantonte ruajtjen e rezultateve të arritura. Mirëmbajtja gjatë 24 muajve mundëson ndërhyrje periodike, kontrolle pas reshjeve dhe trajtim në kohë të problematikave të reja.

Shërbimi i mirëmbajtjes rutinë është konceptuar si një proces proaktiv, i cili nuk duhet të fillojë vetëm pas shfaqjes së dëmtimeve të rënda. Kontrolli periodik i kalueshmërisë, pastrimi i kanaleve dhe tombinove, pastrimi i vegjetacionit, largimi i aluvioneve, heqja e materialeve të rëna nga shpatet, mbushja e gropave, profilimi i rrugëve dhe riparimi lokal i shtresës së çakullit janë ndërhyrje që kanë për qëllim parandalimin e përkeqësimit të gjendjes së rrugës dhe ruajtjen e investimit të kryer.

Në veçanti, specifikimet teknike parashikojnë nevojën për inspektime të veçanta pas periudhave me reshje të forta, pasi këto janë periudhat kur rrugët bujqësore janë më të ekspozuara ndaj dëmtimeve. Kontrollat duhet të përqendrohen veçanërisht në segmentet me pjerrësi, në afërsi të tombinove, në pikat e kalimit të ujërave, në zonat ku janë evidentuar më parë dëmtime dhe në segmentet me rrezik rrëshqitjeje. Kjo kërkesë është teknikisht e nevojshme për të identifikuar në kohë problematikat dhe për të shmangur përkeqësimin e tyre.

Përfshirja e ndërhyrjeve emergjente në objektin e shërbimit është e justifikuar nga natyra e paparashikueshme e dëmtimeve që mund të shkaktohen nga reshjet intensive dhe fenomenet natyrore. Në rast të bllokimit të një rruge, rënies së materialeve nga shpatet, dëmtimit të një tombinoje ose krijimit të gropave të mëdha, vonesa në ndërhyrje mund të sjellë ndërprerje të aksesit të banorëve dhe fermerëve dhe mund të pengojë edhe lëvizjen e mjeteve të emergjencës. Për këtë arsye, kontraktori duhet të ketë kapacitetin teknik dhe organizativ për të realizuar ndërhyrje të shpejta për hapjen e rrugës, largimin e materialeve të rëna, pastrimin e tombinove dhe kanaleve, riparimin e dëmtimeve dhe rikthimin e kalueshmërisë.

Kërkesat për makineritë dhe pajisjet janë përcaktuar duke marrë në konsideratë natyrën e punimeve dhe karakteristikat e terrenit. Për realizimin e gërmimeve, pastrimit, profilimit dhe sistemimit nevojiten makineri të rënda dhe pajisje të përshtatshme për punë në terrene të pjerrëta dhe të vështira. Përdorimi i ekskavatorëve me goma, minieskavatorëve, graderëve, rulave për ngjeshje, kamionëve të transportit dhe mjeteve për pastrimin e vegjetacionit është i nevojshëm për të siguruar realizimin e shërbimit në mënyrë efikase dhe në përputhje me afatet e përcaktuara. Kërkesa për disponimin ose sigurimin e këtyre pajisjeve nuk synon kufizimin e konkurrencës, por garantimin e kapacitetit real të operatorit ekonomik për të përmbushur objektin e kontratës.

Njësia e Prokurimit vlerëson gjithashtu se specifikimet teknike janë hartuar në mënyrë që të lejojnë përshtatjen e ndërhyrjeve me kushtet konkrete të terrenit. Për shkak të ndryshimit të konfiguracionit të zonave rurale, nuk mund të përcaktohet një seksion identik për çdo segment të rrjetit. Për këtë arsye, gjerësia mesatare prej 3.50 m, trashësia orientuese prej 20 cm dhe seksioni tërthor tip janë

përcaktuar si parametra orientues, ndërsa zbatimi konkret do të përshtatet me gjendjen ekzistuese dhe kushtet reale të çdo segmenti, pa ndryshuar funksionin dhe qëllimin e shërbimit.

Kontrolli i cilësisë është përfshirë si pjesë e domosdoshme e specifikimeve teknike për të garantuar që shërbimet të realizohen në përputhje me kërkesat e përcaktuara. Kontrolli duhet të përfshijë verifikimin e gjerësisë dhe profilin të rrugës, kontrollin e materialit të përdorur për shtresën e çakullit, verifikimin e trashësisë pas ngjeshjes, kontrollin e ngjeshjes, funksionimin e kanaleve dhe tombinove, si dhe kontrollin e strukturave të realizuara. Në rast se ndërhyrjet nuk përmbushin kërkesat teknike për shkak të përgjegjësisë së kontraktorit, ato duhet të korrigjohen prej tij në përputhje me kushtet e kontratës.

Dokumentimi i ndërhyrjeve gjatë periudhës së mirëmbajtjes është përcaktuar me qëllim që Autoriteti Kontraktor të ketë një evidencë të plotë dhe të verifikueshme të shërbimeve të kryera. Dokumentimi duhet të mundësojë identifikimin e datës së ndërhyrjes, segmentit ku është ndërhyrë, llojit të dëmtimit, natyrës së shërbimit të realizuar, materialeve dhe makinerive të përdorura, si dhe të përmbajë dokumentim fotografik para dhe pas ndërhyrjes. Kjo kërkesë ndihmon në monitorimin e performancës së kontraktorit, në kontrollin e cilësisë së shërbimit dhe në evidentimin e ndërhyrjeve të kryera gjatë gjithë periudhës së kontratës.

Përcaktimi i mënyrës së matjes dhe pagesës sipas njësive të përcaktuara në preventiv është bërë në funksion të natyrës së ndryshme të shërbimeve që përfshihen në objekt. Për shkak se ndërhyrjet mund të kenë karakteristika dhe volume të ndryshme në segmente të ndryshme, matja e shërbimeve mund të kryhet sipas njësive përkatëse të matjes, në përputhje me preventivin dhe dokumentet kontraktuale. Çdo shërbim do të konsiderohet i matshëm dhe i pagueshëm vetëm pasi të jetë realizuar dhe pranuar nga Mbikëqyrësi i Shërbimit, sipas kushteve të përcaktuara në dokumentacionin e procedurës dhe kontratës.

Njësia e Prokurimit vlerëson se përfshirja e kategorive të ndryshme të shërbimit në të njëjtin objekt është teknikisht e arsyeshme, pasi këto kategori janë të ndërlidhura funksionalisht dhe kanë si qëllim të përbashkët rikthimin dhe ruajtjen e kalueshmërisë dhe funksionalitetit të rrugëve bujqësore. Pastrimi i vegjetacionit, gërmimet, profilimi, sistemimi i çakullit, pastrimi i kanaleve, mirëmbajtja e tombinove, ndërhyrjet me struktura betoni, mirëmbajtja rutinë dhe ndërhyrjet emergjente përbëjnë komponentë të ndryshëm të një shërbimi të integruar për mirëmbajtjen e infrastrukturës rrugore rurale.

Në përfundim, Njësia e Prokurimit konstaton se specifikimet teknike të hartuara janë rezultat i një vlerësimi të nevojave konkrete të Autoritetit Kontraktor dhe të kushteve faktike të rrjetit rrugor bujqësor në territorin e Bashkisë Himarë. Ato synojnë të përcaktojnë kërkesat minimale të nevojshme për realizimin e një shërbimi cilësor dhe funksional, duke ruajtur njëkohësisht fleksibilitetin e nevojshëm për përshtatjen e ndërhyrjeve me kushtet reale të terrenit.

Përcaktimi i parametrave teknikë orientues, si gjatësia totale e rrjetit prej rreth 54.60 km, gjerësia mesatare rreth 3.50 m, intervali i gjerësisë nga 3.00 m deri në 4.00 m dhe trashësia orientuese e shtresës së çakullit prej rreth 20 cm, është bërë mbi bazën e karakteristikave të rrugëve ekzistuese dhe jo me qëllim krijimin e kërkesave të panevojshme apo kufizuese. Parametrat do të verifikohen dhe përshtaten sipas kushteve reale të segmenteve të ndryshme, në përputhje me dokumentacionin kontraktual dhe udhëzimet e Mbikëqyrësit të Shërbimit.

Në vlerësimin e Njësies së Prokurimit, shërbimi i parashikuar është i domosdoshëm për garantimin e aksesit të banorëve dhe fermerëve në tokat bujqësore, ullishtet, pemëtoret dhe kullotat, për përmirësimin e lëvizjes së mjeteve bujqësore, për ruajtjen e lidhjes funksionale të zonave rurale me

qendrat e banuara dhe për garantimin e aksesit të mjeteve të emergjencës, në masën që lejojnë kushtet teknike dhe natyrore të territorit.

Gjithashtu, shërbimi ka rëndësi të veçantë për parandalimin e degradimit të mëtejshëm të rrjetit rrugor rural. Ndërhyrjet e rregullta në pastrimin e kanaleve, mirëmbajtjen e tombinove, sistemimin e shtresës së çakullit dhe trajtimin e dëmtimeve të shkaktuara nga reshjet bëjnë të mundur që dëmtimet të trajtohen në faza të hershme dhe të shmangen ndërhyrjet më të kushtueshme në të ardhmen. Në këtë kuptim, shërbimi i mirëmbajtjes së vazhdueshme përbën një masë parandaluese dhe njëkohësisht një mënyrë për të ruajtur në kohë funksionalitetin e rrjetit ekzistues.

Në përfundim të periudhës 24-mujore të kontratës synohet që rrjeti i rrugëve bujqësore objekt i shërbimit të jetë në gjendje funksionale dhe të sigurojë kalueshmërinë e nevojshme në përputhje me karakterin rural të rrugëve, kushtet e terrenit dhe ndikimin e faktorëve atmosferikë. Kjo do të arrihet nëpërmjet ndërhyrjeve të planifikuara dhe të vazhdueshme, mirëmbajtjes rutinë, ndërhyrjeve pas reshjeve dhe reagimit në kohë ndaj situatave emergjente.

Për sa më sipër, Njësia e Prokurimit vlerëson se specifikimet teknike të hartuara për objektin “Sistemi i rrugëve bujqësore në territorin e Bashkisë Himarë” janë teknikisht të justifikuara dhe të lidhura drejtpërdrejt me objektin e prokurimit. Kërkesat e përcaktuara janë të nevojshme për realizimin e shërbimit, proporcionale me natyrën dhe volumin e ndërhyrjeve, të përshtatura me karakteristikat e territorit dhe të orientuara drejt garantimit të funksionalitetit, sigurisë, aksesueshmërisë dhe qëndrueshmërisë së rrjetit rrugor bujqësor. Specifikimet synojnë që operatori ekonomik të ketë kapacitetin e nevojshëm teknik dhe organizativ për të realizuar shërbimin në mënyrë cilësore, në kohë dhe në përputhje me kërkesat e Autoritetit Kontraktor, duke garantuar njëkohësisht respektimin e kërkesave për sigurinë në punë, mbrojtjen e mjedisit dhe kontrollin e cilësisë.

Në këtë mënyrë, Njësia e Prokurimit vlerëson se dokumentacioni teknik i përgatitur krijon kushtet e nevojshme për realizimin e një shërbimi të plotë dhe të integruar, i cili nuk kufizohet vetëm në rehabilitimin fillestar të rrugëve, por garanton edhe mirëmbajtjen e tyre gjatë një periudhe 24-mujore. Kjo qasje është e nevojshme për të siguruar që rezultatet e ndërhyrjeve fillestare të ruhen dhe që rrjeti i rrugëve bujqësore të mbetet funksional dhe i aksesueshëm gjatë gjithë periudhës së kontratës, duke iu përgjigjur në mënyrë të vazhdueshme nevojave të komunitetit rural, fermerëve, banorëve dhe shërbimeve të emergjencës në territorin e Bashkisë Himarë.

Në përfundim, të gjitha specifikimet teknike të paraqitura janë hartuar në funksion të garantimit të një infrastrukture rrugore moderne, të sigurt, me jetëgjatësi të lartë dhe në përputhje të plotë me standardet europiane të sigurisë dhe performancës. Këto kërkesa sigurojnë cilësi të lartë të materialeve, reduktim të kostove të mirëmbajtjes, rritje të sigurisë së përdoruesve të rrugës dhe qëndrueshmëri afatgjatë të investimit publik.

NJËSIA E PROKURIMIT